



Krijimi i një vendi për dialog:

**Rezultate nga
fokus-grupet në ish
burgun e Spaçit**

Maj-Qershor 2017

Falenderimi ynë i shkon të gjithë pjesëmarrësve të fokus grupeve që ofruan kohën dhe mendimet e tyre në mbështetje të kauzës së kujtesës dhe atë të të drejtave të njeriut.

Një falenderim i veçantë i shkon tre personave që shërbyen si udhërrëfyes gjatë vizitave në kuadër të fokus grupeve: dy ish të dënuar politikë në Spaç – Zenel Drangu dhe Zhivko Petroviç – si dhe banorin vendas që gjithashtu kujdeset për burgun, Gjetë Gjoni.

Projekti “Burgu i Spaçit: Vend për Dialog” dhe fokus grupet e Burgut të Spaçit u organizuan dhe u zbatuan nga:



Falë mbështetjes financiare të:



Kontribuan financiarisht dhe logjistikiht për zhvillimin e fokus grupeve të mëposhtëm dhe partnerët tanë të:

Mësuesit e Lëndës së
Historisë



Turistët e huaj



Studentët nga
Këshilli Rinor





Përmbajtje

| | |
|--|----|
| Pjesa I: Analiza e fokus grupeve | 4 |
| Përshkrim i projektit | 4 |
| Qëllimi i fokus grupeve | 4 |
| Metodologjia | 5 |
| Kufizimet e metodologjisë | 6 |
| Rezultate paraprake | 6 |
| Fokus grupet në Spaç mbi interpretim dhe edukim | 7 |
| Fokus grupet në Spaç mbi konservimin, ripërdorimin dhe infrastrukturën | 9 |
| Fokus grupet në Spaç mbi administrimin, menaxhimin dhe qasjet strategjike | 11 |
| Përfundime | 12 |
| Pjesa II: Përmbledhje e diskutimeve për secilin fokus grup | 14 |
| 1. Mësuesit e lëndës së historisë | |
| Përmbledhje e fokus grupit | 14 |
| Rezultatet e pyetësorit | 16 |
| 2. Turistët e huaj | |
| Përmbledhje e fokus grupit | 17 |
| Rezultatet e pyetësorit | 20 |
| 3. Profesionistët e muzeve | |
| Përmbledhje e fokus grupit | 21 |
| Rezultatet e pyetësorit | 24 |
| 4. Operatorët turistikë | |
| Përmbledhje e fokus grupit | 25 |
| Rezultatet e pyetësorit | 28 |
| 5. Studentë (Këshilli Rinor i Ambasadës Amerikane) | |
| Përmbledhje e fokus grupit | 29 |
| Rezultatet e pyetësorit | 31 |
| 6. Studentët e Menaxhimit të Trashëgimisë Kulturore dhe Arkeologjisë | |
| Përmbledhje e fokus grupit | 32 |
| Rezultatet e pyetësorit | 35 |

Pjesa I: Analiza e fokus grupeve

“Spaçi është pjesë e dialogut mes brezave.”

*Student shqiptar/Këshilli Rinor i Ambasadës së ShBA-ve
Fokus-grup Spaç 5, 29 qershor 2017*

PËRSHKRIM I PROJEKTIT

Prej disa vitesh tashmë, Trashëgimia Kulturore pa Kufij Shqipëri (CHwB Albania) po punon me ish burgun e Spaçit. Ky ish burg politik e kamp pune të detyruar në malesinë veri-qendrore të Shqipërisë është i njohur për trajtimin e ashpër që i bënte të burgosurve politikë gjatë regjimit komunist. Famëkeq për kushte çnjerëzore të punës në miniera, ish burgu i Spaçit u fiksua në memorien kolektive nëpërmjet revoltës së majit të vitit 1973, gjatë së cilës të burgosurit morën kontrollin e burgut për një kohë të shkurtër, duke bërë thirrje për demokraci e për respektim të të drejtave të njeriut. Me rënien e regjimit komunist, burgu i Spaçit u mbyll e nisi të degradonte, edhe pse një pjesë e ish të burgosurve kanë bërë përpjekje për ta mbajtur këtë histori të gjallë e për ta ruajtur këtë vend si një memorial. Në 2007 siti u shpall monument kulture i kategorisë së dytë, sipas ligjit shqiptar, por asnjë investim nuk është bërë për ta konservuar apo interpretuar.

CHwB Albania nisi të punojë me burgun e Spaçit në 2013-14, nëpërmjet një serie me punëtori me grupet e interesit, të titulluara “Dialogë për Spaçin”, financuar nga International Coalition of Sites of Conscience – Koalicioni Ndërkombëtar i Siteve të Ndërgjegjes dhe Qeveria e Suedisë. Këto punëtori ishin menduar si një hap i parë drejt procesit të kthimit të ish burgut në një vend bashkëkohor ndërgjegjshëm e dialogu – një vend për vuajtjet dhe kurajon e ish të burgosurve, që lidhet më çështjet me të cilat Shqipëria përballet aktualisht. “Dialogë për Spaçin” u pasua nga “Plani i veprimit për

Spaçin”, i cili po ndiqet nga CHwB Albania.

Në 2017 CHwB Albania ndër morri dy nisma të tjera me qëllim mbrojtjen dhe aktivizimin e sitit: 1) ndërhyrje strukturore emergjente për të ndaluar shkatërrimin e mëtejshëm të ndërtesave; 2) organizimi i një sërë fokus-grupeve me bashkësi të ndryshme. Këto takime i shërbejnë një plani gjithëpërfshirës që synon krijimin e një plani interpretimi dhe koncepti përdorimi për sitin, ndërkohë që propozon një itinerar më të sigurtë e sistematik për vizitorët (shiko “metodologji” më poshtë).

QËLLIMI I FOKUS GRUPEVE

Kjo seri fokus grupesh për ish burgun e Spaçit vë në praktikë një teknikë që nuk përdoret shumë shpesh në Shqipëri, që ka të bëjë me përfshirjen e audiencave të evidentuara dhe grupeve të interesit në fazat e para të zhvillimit të konceptit për ish burgun e Spaçit. Një sërë projektesh në lidhje me kujtesën në Shqipëri kohëve të fundit duket të jenë zhvilluar në izolim, duke ia shfaqur papritur produktin përfundimtar masës. Duke dashur të shmangnim “imponimin” e një muzeu në Spaç, CHwB Albania përdori përfshirjen e mëparshme të disa profesionistëve të interesuar për të krijuar një seri fokus grupesh për të ardhmen e ish burgut të Spaçit.

Qëllimi i këtyre fokus grupeve ishte të afronin një përfaqësi të shoqërisë shqiptare ballë për ballë me historinë dhe situatën aktuale të ish Burgut të Spaçit e më tej, të mësonte prej tyre çfarë duhet bërë me këtë sit. Këto takime i lejuan disa prej vizitorëve të ardhshëm të jepnin

një kontribut aktiv drejt mbrojtjes së sitit, si dhe rritjen vetëdijësimin në lidhje me shkatërrimin e siteve të persekutimit komunist. Më specifikisht, synimet e këtyre fokus-grupeve ishin:

1. Vlerësimi i vizitës me guidë dhe i itinerarit të ndjekur (cilësia e informacionit, ndërveprimi, siguria, interesi, etj)
2. Identifikimi i nevojave kryesore të vizitorëve në sit (shërbime, etj)
3. Mbledhja e prioriteteve, pritshmërive dhe ideve në lidhje me përdorimin e sitit në të ardhmen (aktivitete, niveli i restaurimit, muze, art, etj) nga vizitorët.

Në përfundim, synimi i përgjithshëm i fokus grupeve dhe i analizës është dhënia e përgjigjes ndaj pyetjes: **Si e përjetojnë njerëzit Spaçin në formën që është sot? Si duan ta shohin atë në të ardhmen?**

Hapi i radhës do jetë përdorimi i rezultateve të fokus grupeve për të dhënë informacion në lidhje me planin e interpretimit dhe konceptin e përdorimit të ish burgut të Spaçit. Në të njëjtën kohë, CHwB Albania do të punojë për të krijuar një itinerar bazë, të sigurtë e efektiv, në mënyrë që të mundësojë rritjen e numrit të vizitave në sit. Rritja e numrit të vizitave, të njerëzve që do kenë një përvojë të çmuar në Spaç është një hap thelbësor drejt mbrojtjes së sitit.

METODOLOGJIA

Gjashtë fokus grupet përfshinë audiencë të ndryshme në lidhje me pritshmëritë e tyre për punën vijuese në ish burgun e Spaçit (shiko "Rezultate paraprake" më poshtë për listën e fokus grupeve). Nëpërmjet projektit "Dialogë për Spaçin" dhe takimeve të punës që e ndoqën ne arritëm të krijojmë një përvojë pozitive në përfshirjen e grupeve të interesit me formim profesional e personal të ndryshëm, duke përfshirë ish të burgosur politikë, profesionistë të trashëgimisë, kineastë, studentë, aktivistë,

banorë të zonës dhe përfaqësues të institucioneve në nivel lokal e qendror. Në mënyrë që të rrisim inputin në të ardhmen e ish burgut të Spaçit ne i strukturuar fokus grupet në mënyrë të tillë që të përfaqësoheshin grupet e interesit të përfshira më parë, por edhe grupe të tjera që nuk ishin përfshirë më parë.

Në nisje të aktivitetit pjesëmarrësve iu kërkohet të firmosnin një marreveshje për pjesëmarrje (kopje të së cilës mund ta marrin me vete), ku shënohet se ata kuptonin dhe binin dakord të marrin pjesë në fokus grup. Ata që vendosnin të marrin pjesë drejtoheshin nga një guidë në një vizitë në ish burgun e Spaçit. Vizita zgjaste rreth një orë dhe drejtohet nga një ish i burgosur politik, ose nga një banor i zonës. Kjo vizitë pasohet nga një diskutim fokus grup, pranë ish burgut.

Pjesë e aktivitetit ishte plotësimi i një pyetësori të shkurtër në dy pjesë: pjesa e parë para nisjes së vizitës dhe e dyta menjëherë pas vizitës. Dy pjesët e pyetësorit ishin realizuar në mënyrë të tillë që të reflektonin njëra-tjetrën, në mënyrë që të vlerësonin reagimin e vizitorëve ndaj vizitës në sit. (Shikoni çiftet e pyetjeve para/pas në seksionin "rezultatet e pyetësorit" tek përmbledhjet e secilit fokus grup.) Pyetësorët i dhanë një aspekt sasior impaktit të vizitës, në aspektin e lidhjes personale, njohurive të përfituara dhe efektin e një dëshmie të gjallë.

Pas vizitës, pjesëmarrësit u përfshinë në një seancë fokus grupi, që zgjaste rreth një orë, një ore e gjysmë. Këto diskutime mundësonin disa reflektime pak më të thelluara. Ato zhvilloheshin sipas një strukture të caktuar e cila ishte krijuar për të arritur synimet e lartpërmendura dhe që ndryshonte pak nga grupi në grup, në varësi të përvojës e formimit të secilit grup.

Për të garantuar saktësinë e informacionit të mbledhur gjatë diskutimeve, CHwB Albania regjistroi audion e secilit diskutim, në dijeni dhe

dakordësi të pjesëmarrësve. Këto regjistrime do të shfrytëzohen vetëm për përdorim të brendshëm të CHwB Albania për analizimin e diskutimeve.

Gjatë procesit, CHwB Albania mori masa për të garantuar konfidencialitetin e diskutimit dhe anonimitetin e pjesëmarrësve. Për të mbrojtur identitetin e pjesëmarrësve, CHwB Albania nuk do të përdorë emrat, inicialet apo forma të tjera të identifikimit të pjesëmarrësve në asnjë prej raporteve apo publikimeve. Për këtë arsye, përmbledhja dhe rezultatet e mëposhtme do t'i referohen pjesëmarrësve vetëm në lidhje me grupin të cilin ata bënin pjesë.

KUFIZIMET E METODOLOGJISË

Disa faktore na kufizuan në krijimin e një studimit aq gjithëpërfshirës e të rrjedhshëm sa ishte menduar në fillim. Këto faktore na mundësojnë përmirësimin e procesit dhe përfshirjen e mëtejshme të reagimit të publikut në zhvillimin e ish burgut të Spaçit si një vend ndërgjegjeje.

Buxheti i kufizuar për fokus grupet ndikuan në rezultate në dy mënyra. Së pari, CHwB Albania nuk kishte mundësi të punësonte një moderator profesionist të fokus grupeve. Moderimi i takimeve u bë nga stafi i CHwB Albania. Edhe pse trajnimi profesional në teknikat e moderimit të fokus grupeve mungon, stafi shfrytëzoi përvojat e mëparshme në drejtimin e punëtorive e trajnimeve. Njohja e mirë e sitit dhe e punës së organizatës aty mundësoi diskutime mjaft të fokusuar, por në të njëjtën kohë krijoi një prirje të stafit për të ndërhyrë shpesh në diskutim. Pasoja e dytë e fondeve të kufizuara ishte pamundësia për të patur një hapësirë të qetë të dedikuar për takimet. Për pasojë, diskutimet u organizuan në lokale e restorante pranë sitit, ku zhurmat ishin herë pas here shkak shpërqëndrimi, si për diskutimin ashtu edhe për regjistrimin audio.

Deri më tani CHwB Albania ka organizuar gjashtë seanca fokus grupesh, duke u përballur me disa kufizime sa i takon profileve të njerëzve të përfshirë. Në shumicën e rasteve, duke përjashtuar një pjesë të mirë të mesuesëve dhe operatorëve turistikë, personat e përfshirë ishin pjesë e rrjetit të kontakteve të CHwB Albania-s. Pavarësisht se këta persona nuk ishin konsultuar më parë në lidhje me ish burgun e Spaçit, ata sidoqoftë nuk u përzgjedhën rastësisht nga publiku i gjërë – kjo do të thotë se ata mund të kenë qënë të prirur për të mbështetur punën e CHwB Albania me ish burgun e Spaçit. Me zhvillimin e mëtejshëm të procesit e zhvillimit të ish burgut të Spaçit, puna kërkimore në të ardhmen duhet të përfshijë një audiencë më të gjërë, duke përfshirë një përzgjedhje të gjërë të përdoruesëve të ardhshëm të sitit. Gjithashtu, deri në shtator 2017, CHwB Albania nuk ka arritur të realizojë disa nga fokus grupet e parashikuara me grupet kryesore të interesit: banorë të zonës, ish të burgosur politikë dhe anëtarë të trupit diplomatik ndërkombëtar në Shqipëri.

REZULTATE PARAPRAKE

Në periudhën 6 maj – 30 qershor 2017 CHwB-Albania organizoi 6 fokus grupe, me 49 pjesëmarrës (33 femra dhe 16 meshkuj). Gjashtë grupet përfshinin:

1. Mësues të lëndës së historisë, 6 maj
2. Turistë të huaj, 21 maj
3. Profesionistë të muzeve, 21 qershor
4. Operatorë turistikë, 22 qershor
5. Studentë universitarë (fusha të ndryshme) nga Këshilli Rinor i Ambasadës Amerikane, 29 qershor
6. Studentë universitarë të menaxhimit të trashëgimisë kulturore dhe arkeologjisë, 30 qershor

Nga të gjithë pjesëmarrësit në fokus grupe,

37 ishin shqiptarë e 12 të huaj. Për sa i takon grupmoshave, 15 pjesëmarrës ishin të moshave 20-24 vjeç, që do të thotë që nuk mund të kenë asnjë kujtim personal të periudhës së komunizmit; 10 pjesëmarrës ishin të moshave 30-38, që do të thotë që kanë qënë shumë të rinj në 1992, kur regjimi komunist ra; 6 pjesëmarrës ishin të moshave 41-44 – adoleshentë gjatë ndërrimit të regjimeve; 15 pjesëmarrës ishin mbi 50 vjeç, që do të thotë që në fund të regjimit komunist në Shqipëri kanë qënë adultë.¹

Rezultatet e përgjithshme të mëposhtme janë të organizuara në bazë të tre kategorive të veprimit, pjesë e “Plani i veprimit për Spaçin”: interpretimi dhe edukimi; konservimi i ndërtesës, adaptimi dhe infrastruktura; dhe, administrimi, menaxhimi dhe qasja strategjike. Këto kategori mundësojnë një kornizë ndihmëse për të kuptuar llojet e ndryshme të punëve që duhen ndërmarrë në Spaç. Gjithashtu, pothuajse çdo gjë e thënë nga pjesëmarrësit e fokus grupeve mund t’i përkasë një apo më shumë prej këtyre kategorive.

Fokus grupet në Spaç mbi interpretim dhe edukim

“Edhe këta që punonin gjithmonë për sistemin, të lirë nuk ishin.”

*Student shqiptar i menaxhimit të trashëgimisë kulturore edhe arkeologjisë
Fokus Grup 6 Spaç, 30 qershor 2017*

Gjatë fokus grupit, interpretimi dhe edukimi ishin qartazi dy temat më të diskutuara. Duke marrë në shqyrtim pikat e ndryshme të diskutimit, qasja ndaj interpretimit dhe edukimit në ish burgun e Spaçit e tejkalon numrin e herëve që pjesëmarrësit përmendën ndërhyrjet fizike të konservimit apo edhe çështje të administrimit e menaxhimit të sitit. Kjo tregon se cili është prioriteti i pjesëmarrësve në fokus grup dhe tregon që interpretimi dhe edukimi duhet të drejtojnë procesin e kthimit të ish burgut të Spaçit në një vend ndërgjegjeje.

Në thelb të përjasjes interpretuese dhe edukative të Spaçit qëndronte **roli kyç i dëshmimeve të gjalla**, si një mënyrë për të treguar historinë e këtij vendi. Meqë udhërrëfimi i drejtëpërdrejtë u përzgjedh si forma e

interpretimit për t’u servirur pjesëmarrësve, nuk ka ende një bazë krahasuese për mënyrat e tjera të mundshme të interpretimit. Sidoqoftë, aspekti i dëshmimeve të gjalla si pjesë e vetë udhërrëfimit u vlerësua së tepërmi nga pjesëmarrësit. Të gjithë fokus grupet kanë përmedur impaktin e të paturit të një vizite të drejtuar nga dikush me lidhje personale me ish burgun.² Duke ndarë përvojën e tyre personale, këta persona prezantuan “rrëfimin e vuajtjes (...) që nuk mund të tregohet ndryshe përveç se në vetën e parë.”³ Kjo përvojë emocionoi pjesëmarrësit, duke i ndihmuar për të ndjerë në mënyrë të drejtë për drejtë ndikimin e asaj që ka ndodhur në Spaç.

Pasja e një dëshmitari si guide, jo vetëm i shton vlera vizitës në sit, përshtypja e përgjithshme

¹ Mosha e 3 pjesëmarrësve nuk dihet.

² Ky impakt reflektohet edhe në përgjigjet ndaj pyetjes 10 të pyetësorit “Sa e dobishme për të kuptuar këtë vend është vizita e drejtuar nga një ish i burgosur politik?”. 43 nga 48 janë përgjigjur me “Ndikoi shumë”.

³ Fokus grup me operatorë turistikë, 22 qershor 2017.

e fokus grupeve ishte që kjo lloj guide është thelbësore për të kuptuar sitin, veçanërisht në mungesë të interpretimit. Për fokus grupin e turistëve të huaj lidhja personale e guidës rriti autenticitetin e sitit:

“Ishte e veçantë të kishim si guidë këtë person, i ati i të cilit ka punuar në burg, i cili e ka kaluar jetën e tij duke qënë një dëshmitar. Ai ishte autentik (...) Jeta e tij është të qëniti dëshmitar i asaj ku familja e tij ka bërë pjesë, më dëshirë ose jo, gjatë atyre viteve.”⁴

Ky grup mendonte se, edhe pse guida nuk kishte qënë vetë i burgosur politik, lidhja personale (bazuar në një përvojë familiare ose personale në Spaç) ishte e rëndësishme. Sidoqoftë, fokus grupet ndaheshin në mendimet e tyre se në ç’mënyrë mund të paraqiten historitë e shumta personale nga Spaçi. Ndërsa disa fokus grupe këshilluan promovimin e sitit dhe rritjen e vizitueshmërisë duke i kushtuar hapësirë për fokusim personazheve të njohur që janë burgosur në Spaç, fokus grupi i operatorëve turistikë nuk ishte dakord me këtë qasje. Ata nuk donin që t’i “veçonin” personat e famshëm nga “anonimet dhe të pafatët” që gjithashtu kanë vuajtur në burg e minierë. Pavarësisht qasjes, disa fokus grupe ishin dakord që grumbullimi i historive është një hap thelbësor për projektin e ish burgut të Spaçit – si një mjet për kërkimin e për interpretimin. Sot, 25 vite pas mbylljes së burgut, ata që vuajtën po plaken e ndahen nga jeta, fakt që e bën urgjente nëvojen e dokumentimit të historive të tyre.

Kur morën në shqyrtim **tema bashkëkohore interpretative** që mund t’i japin ish burgut të Spaçit rëndësi në jetën e vizitorëve sot, pjesëmarrësit e fokus grupeve propozuan një

gamë të gjërë idesh. Disa e lidhën me çeshtjen e skllavërisë moderne dhe kushteve të vështira të minatorëve sot. Të tjerë mendonin se Spaçi duhet të jetë një vend për të eksploruar mbi perceptimin e të drejtave të njeriut dhe barazisë para ligjit – duke vënë në pikëpyetje shkallën në të cilën gëzohen këto të drejta sot. Disa propozuan që ish burgu i Spaçit duhet të eksplorojë mbi idenë se komunizmi nuk ka qënë “bardh e zi”. Shpesh, marrëdhënia e njerëzve me ish regjimin komunist nuk i përshtatet kategorive “viktimë” apo “persekutues”. Nën atë sistem kush ishte në të vërtetë i lire dhe kush ishte i burgosur? Cila ishte marrëdhënia midis individit dhe fuqisë dhe cila është trashëgimia e kësaj marrëdhënieje me pushtetin sot? Si tha dhe një nga pjesëmarrësit: “Edhe këta që punonin gjithmonë për sistemin, të lirë nuk ishin.”⁵ Pranimi i historive me aspekte të shumta gjatë komunizmit krijon mundësinë për eksplorimin e historive të lëna në hije, si ato të lidhura me identitetin gjinor e seksual.

Për të gjithë fokus grupet, brezi i ri i shqiptarëve është një audiencë e rëndësishme, duke nënkuptuar që ish burgu i Spaçit **duhet të jetë i lidhur me shkollat** në mënyra të ndryshme. E para është përfshirja e mësimeve mbi ish burgun e Spaçit dhe vendeve të tjera të persekutimit në kurrikulën mësimore. “Një mënyrë memorializimi është futja e vizitave dhe e informacionit relevant në kurrikula. Pjesa e diktaturës është lënë totalisht jashtë.”⁶ Fokus grupet me mësues dhe ato me studentë komentuan se historia e periudhës së komunizmit në Shqipëri nuk mesohet në shkolla. Sigurisht, paralelisht me përfshirjen e ish burgut të Spaçit në kurrikulën mësimore, mënyra e dytë për të arritur te nxënësit e shkollave ishte organizimi i vizitave në sit. Këto vizita do të përqëndroheshin te nxënësit e shkollave të mesme, në mënyrë që të arrihej grupmosha e

⁴ Fokus grup me turistë të huaj, 21 maj 2017.

⁵ Fokus grup me studentë universitarë të menaxhimit të trashëgimisë kulturore dhe arkeologjisë, 30 qershor 2017.

⁶ Fokus grup me mësuesit e lëndës së historisë, 6 maj 2017.

duhur për këtë histori shqetësuese. Por, si tha një student nga Këshilli Rinor i Ambasadës Amerikane: “Është më mirë informues se sa një vizitë në liqen me një piknik.”⁷

Të tjera mendime të rëndësishme, në lidhje me interpretimin dhe edukimin në ish burgun e Spaçit përfshinë:

- Ndërveprimi, por në një mënyrë të ndjeshme: “nuk dua që të komercializohet që të shkojnë njerëzit e të bëjnë foto, selfi ... se kjo gje është mungesë respekti totalisht.”⁸
- Shumëzërësh: përfshirja e perspektivave

të shumta e të ndryshme në interpretimin e sitit

- Detaje historike bazuar në një kërkim të mirëfilltë: interpretimi i sitit duhet “Të ngrihet mbi bazën e fakteve dhe përvojave jetike të vërteta dhe jo në bazë të thashethemeve (...) politika nuk duhet të futet fare këtu.”⁹ Çdo interpretim i sitit duhet të përfshijë emrat e viktimave – mbase një proces i ndërlikuar, duke patur parasysh natyrën e vështirë të kategorive “viktimë” dhe “persekutues”.
- Aksesit: përfshirja që tani e personave me aftësi të kufizuara dhe aksesit të tyre në sit.

Fokus grupet në Spaç mbi konservimin, ripërdorimin dhe infrastrukturën

“Nuk mund të ringjallësh një organizëm të vdekur. Mund ta konservosh, ta mbash në një gjendje të tillë. Fundja kjo është dekompozimi që i ka ndodhur memories tonë kolektive në këto 27 vite”

*Operator tursitik shqiptar
Fokus Grup 4 Spaç, 22 qershor 2017*

Disa nga pikat e diskutimit gjatë fokus grupeve lidheshin me atë çfarë mund të bëhej fizikisht me ndërtesat, peizazhin dhe infrastrukturën e ish burgut të Spaçit. Pjesëmarrësit shkëmbyen mendime mbi çfarë do t’i nevojitej vizitorëve (atyre vetë apo dhe të tjerëve), nevojat infrastrukturore që mundësojnë qasjen dhe lëvizjen në sit, si dhe ndërhyrjet restauruese që do të ndihmonin të kuptuarit dhe të interpretuarit e sitit.

Në përgjithësi, **siguria e vizitorëve** ishte çështja kryesore që duhet të udhëheqë ndërhyrjet e para fizike. Për të mundësuar një ambient

të sigurtë për vizitorët, pjesëmarrësit e fokus grupeve propozuan konsolidimin e ndërtesave, riparimin e shkallëve, vendosjen e parrakëve, pastrimin e sitit, rrethimin e zonave ku nuk duhet kaluar, në mënyrë që të kontrollohen më lehtësisht grupet e vizitoreve, dhe garantimin e ndihmës së shpejtë në rast nevojë. Gjithashtu e rëndësishme u vlerësua nevoja për tualete dhe ujë (duke qënë se tualeti me i afert është në rrugën kryesore, 7km larg) dhe një itinerar me i niveluar (sipërfaqe për kalim e niveluar, mbase mbi terrenin, shkallë më të lehta, etj).

Në lidhje me **konservimin fizik** të ndërtesave

⁷ Fokus grup me studentë (fusha të ndryshme) nga Këshilli Rinor i Ambasadës Amerikane, 29 qershor 2017.

⁸ Fokus grup me studentë universitarë të menaxhimit të trashëgimisë kulturore dhe arkeologjisë, 30 qershor 2017.

⁹ Fokus grup me mësuesit e lëndës së historisë, 6 maj 2017.

dhe peizazhit të ish burgut të Spaçit, pjesëmarrësit nuk dëshironin të shihnin një restaurim të plotë të burgut. Pjesa më e madhe propozuan një kombinim nivelesh të ndryshme të një ndërhyrjeje të kufizuar e të kujdesshme, mbase të implementuar në faza, që përqëndrohet në elementët më karakteristikë të burgut, veçanërisht hyrja kryesore, rrethimi, kullat e kontrollit dhe qelitë. Këto janë elementët që ndihmojnë vizitorët për të vizualizuar e kuptuar sitin si një burg. "E parë kështu si është tani duket si ato fabrikat e vjetra të kohës së komunizmit."¹⁰

Të tjerë vlerësuan si më të rëndësishëm konservimin e ndërtesave, se sa restaurimin e tyre, duke qënë se degradimi i sitit është pjesë e historisë së tij dhe tregon mbi memorien kolektive në Shqipërinë post komuniste. Ky perceptim thekson lidhjen mes konservimit dhe interpretimit të sitit. Pasi të jenë adresuar nevojat urgjente fizike (si për shembull konsolidimi dhe stabilizimi emergjent), konservimi i ish burgut të Spaçit duhet të përqëndrohet në theksimin e domethënies së sitit. "pasi ta ruani fizikisht, duhet të vazhdoni ta bëni gjithmonë e më domethënës."¹¹ Në disa raste, pjesëmarrësit theksuan nevojën për të ruajtur me kujdes çdo element autentik të mbetur në sit, si vizatimet e të burgosurve në mure dhe parullat e Partisë Komuniste.

Në disa raste, pjesëmarrësit e fokus grupeve menduan mbi **funksione** të mundshme të

ndërtesave të ndryshme në sit. Disa menduan se pjesë nga ndërtesat e administratës mund të përdoren për arkivë apo dokumentacion, duke përfshirë një magazinë për objektet e gjetura në sit. Propozime të tjera përfshinë idenë e restaurimit të plotë të një qelie në gjendjen në të cilën ka qënë kur burgu ishte funksional, dhe shfrytëzimin e qelive të tjera për ekspozita. Pjesëmarrësit gjithashtu u shprehën se aksesimi në miniera duhet të mbrohet pasi ato kanë qënë një pjesë integrale e kompleksit të burgut. Një propozim përfshinte krijimin e një rruge për të varret e të burgosurve, për të ngritur atje një memorial.

Një tjetër pikë e rëndësishme diskutimi ishte se **çfarë duhet bërë me rrugën** drejt sitit. Aktualisht, një rrugë me zhavor shkon për 7km që ndajnë Spaçin nga rruga kombëtare. Kompania e minierës që po punon në sit ka përmirësuar ndjeshëm sigurinë dhe aksesibilitetin e kësaj rruge gjatë dy viteve të fundit. Sidoqoftë, shtrimi dhe masat e sigurisë, si mbrojtëset anësore, mungojnë. Gjatë disa fokus grupeve pjesëmarrësit debatuan mbi përfitimet nga asfaltimi i rrugës apo nga lënia e saj në gjendjen aktuale, për t'i bërë vizitorët të kuptojnë sado pak, sa e vështirë ka qënë për të burgosurit dhe familjet e tyre për të arritur në Spaç gjatë periudhës komuniste. Të tjerë propozuan një kompromis: shtrimin e rrugës deri te ish burgu dhe lënien e pjesës së fundit, nga kullat e punëtorëve të hyrja, si është.

¹⁰ Fokus grup me studentë universitarë të menaxhimit të trashëgimisë kulturore dhe arkeologjisë, 30 qershor 2017.

¹¹ Fokus grup me turistë të huaj, 21 maj 2017.

Fokus grupet në Spaç mbi administrimin, menaxhimin dhe qasjet strategjike

“Ne nuk mund të marrim Spaçin dhe ta çojmë në Tiranë. Por, duhet të marrim Tiranën dhe ta sjellim në Spaç.”

*Profesionist shqiptar i muzeve
Fokus Grup 3 Spaç, 21 qershor 2017*

Fokus grupe të ndryshme ndërmorën qasje të ndryshme sa i takon mënyrës se si ish burgu i Spaçit duhet menaxhuar e administruar në të ardhmen. Disa nga pjesëmarrësit u përqëndruan te nevojat dhe prioritetet lidhur me stafin, ndërkohë që disa të tjerë erdhën me disa propozime se cilat janë mënyrat më të mira për të promovuar sitin dhe për ta lidhur me asete të tjera vendase. Pati një dakordësi mbi faktin se projekti **duhet të përfshijë vendasit**, si mësues nga Rrësheni apo banorë vendas, si guida. Në mënyrë që siti të jetë i qëndrueshëm duhet t'i shërbejë komunitetit përreth dhe duhet të mbështetet, në ndonjë formë, nga bashkia. Banorët e Mirditës duhet të jenë forca shtytëse drejt krijimit dhe mirëmbajtjes se ish burgut të Spaçit si një sit që është i lidhur me rajonin, jo vetëm diçka e imponuar ndaj Mirditës – si ishte burgu gjatë regjimit komunist. Duke përforcuar këtë lidhje me rajonin, Spaçi duhet të lidhet edhe me asete të tjera turistike në zonën përreth, përveç siteve ndërkombëtare të kujtesës. Në këtë mënyrë, njerëzit do të kuptojnë se Spaçi nuk është e vetmja arsye për të vizituar Mirditën dhe se atje ka më shumë pika që do tërhiqin turistë e më shumë mundësi për të promovuar sitin.

Disa nga fokus grupet dakorduan mbi faktin se Spaçi **duhet promovuar** në mënyrë agresive në shkallë kombëtare e ndërkombëtare, siç janë promovuar projekte të tjera të koheve të fundit. Njerëzit nuk duhet t'i frikësohen idesë

se të shkuarit nga Tirana në Spaç. Ata duhet të kuptojnë që me një orë e gjysmë udhëtim në makinë “Spaçi s’është larg fare nga qendra.”¹² Distanca gjeografike midis Tiranës dhe Spaçit është më e vogël se distanca mendore mes tyre. Si u theksua gjatë fokus grupit me profesionistë të muzeve, historia e Spaçit e humb një pjesë të ndikimit të saj kur tregohet larg vetë vendit. Për të ruajtur autenticitetin dhe ndjenjën e vendit, nuk mjafton të hapet një muze për Spaçin në Tiranë. “Ne nuk mund të marrim Spaçin dhe ta çojmë në Tiranë. Por, duhet të marrim Tiranën dhe ta sjellim në Spaç.”¹³ Disa nga turistët e huaj mendonin se do të ishte mirë që një muze për Spaçin të vendosej në një qytet kryesor të vendit, ku njerëzit të mund të shkonin më lehtësisht. Nga ana tjetër, disa argumentuan se përvoja autentike është në sit, e kjo e bën vendin thelbësor. “Njerëzit duan autenticitet. (...) Vendndodhja fizike është pjesë e rëndësishme e historisë.”¹⁴ Ata mendonin se nëse siti do të reklamohej fuqimisht, njerëzit do ta vizitonin dhe tërheqja e vizitorëve shqiptarë do jetë thelbi i suksesit në tërheqjen e vizitorëve të huaj. Në mënyrë që të lehtësohej vizita, Spaçi mund të kishte orare vizitash, një roje që të mund të orientojë vizitorët në sit dhe ndoshta, një mjet transporti midis Repsit/Rrëshenit dhe Spaçit.

Një tjetër element që mund të ndikojë vizitorët në ish burgun e Spaçit është vendosja e një bilete hyrjeje. Pjesëmarrësit e fokus grupeve

¹² Fokus grup me studentë (fusha të ndryshme) nga Këshilli Rinor i Ambasadës Amerikane, 29 qershor 2017.

¹³ Fokus grup me profesionistë të muzeve, 21 qershor 2017.

¹⁴ Fokus grup me turistë të huaj, 21 maj 2017.

ishin dakord mbi faktin se siti nuk mund t'i mbulojë shpenzimet me anë të biletave të hyrjes, kështuqë propozuan vendosjen e një bilete me çmim të ulët e të përbalueshëm si qasjen më të mirë, për të mos e kthyer çmimin në barrierë për vizitorët. Disa të tjerë mendonin se nuk duhet të ketë biletë hyrjeje, duke thënë: "Mos financojmë harresën duke kërkuar pagesë në hyrje të vendeve të tilla."¹⁵ Sidoqoftë, ish burgu i Spaçit do të duhet të kërkojë mënyra të tjera për mbështetje financiare, duke përfshirë pushtetin vendor e qëndror. Për pjesëmarrësit e fokus grupit me profesionistë të muzeve, përpjekjet për përfshirjen e institucioneve publike duhet të jenë të vazhdueshme. "Ne duhet të mbjellim njerëz farë në projekt."¹⁶

Mendimet ishin të ndryshme nëse menaxhimi i sitit duhet të jetë privat apo publik, por të gjithë pjesëmarrësit dakordonin se duhet të ketë një përfshirje të qeverisë në një nivel të caktuar. Sidoqoftë, do jetë shumë e rëndësishme të minimizohet ndërhyrja e politikës ose, nëse është e mundur, të shmanget plotësisht. Një nga shqetësimet e shprehura ishte se siti mund

të përdoret për interesa politike të përkohshme.

Pavarësisht nëse siti është privat apo publik, një tjetër aspekt i rëndësishëm i menaxhimit të ish burgut të Spaçit si një vend ndërgjegjeje është stafi. Cilët do të jenë ata që do të marrin vendime dhe do ta mbajnë hapur sitin? Disa pjesëmarrës të fokus grupeve mendonin se identifikimi i stafit të mundshëm mund të fillojë që tani, njerëz që do ta menaxhonin sitin larg interesave politike e që nuk janë emocionalisht të lidhur me historinë e tij. "Nuk mund t'i lihet vendimarrja atyre që kanë qenë brenda, apo atyre të krahut tjetër, duhet të jetë një dorë tjetër, një brez i ri që s'ka gjë për të fshehur..."¹⁷ Disa prej grupeve theksuan rëndësinë e menaxhimit dhe zhvillimit të sitit në një mënyrë të drejtë nga brezi i ri (lindur pas viteve 1990). Studentë, pjesë e Këshillit Rinor të Ambasadës Amerikane u shprehën kështu: "Prindërit tanë kanë shumë komplekse me atë periudhë (...) Janë shumë subjektivë se e kanë jetuar vetë. E kanë më shumë emocione. Kurse ne jemi më të ftohtë."¹⁸

Përfundime

"...kjo të jep forcë që ne sot, në momentin që na shkelin të drejtat, të mos heshtim."

*Student shqiptar/anëtar i Këshillit Rinor të Ambasadës Amerikane
Fokus Grup 5 Spaç, 29 qershor 2017*

Në përgjithësi, rezultatet e gjashtë fokus grupeve prekin disa nga çështjet më të rëndësishme me të cilat siti përballet aktualisht. Pjesëmarrësit e fokus grupeve ndanë mendimet e tyre të detajuara në lidhje me si, sipas tyre, siti duhet interpretuar dhe prezantuar te vizitorët,

duke vënë theksin mbi rolin kyç të historive dhe dëshmimeve të drejt për drejta në proces. Pjesëmarrësit menduan, jo në të njëjtën shkallë detaji, mbi prioritetet në lidhje me konservimin, sigurinë publike dhe aksesin. Ata propozuan qasje administrative për t'u përdorur, apo dhe

¹⁵ Fokus grup me mësuesit e lëndës së historisë, 6 maj 2017.

¹⁶ Fokus grup me profesionistë të muzeve, 21 qershor 2017.

¹⁷ Fokus grup me operatorë turistikë, 22 qershor 2017.

¹⁸ Fokus grup me studentë (fusha të ndryshme) nga Këshilli Rinor i Ambasadës Amerikane, 29 qershor 2017.

shmangur. Megjithatë, shumë nga çështjet më të vështira në lidhje me zhvillimin e sitit nuk u diskutuan gjerësisht apo me detaj. Këtu përfshijmë burimet financiare për investimin në sit, çfarë duhet bërë në lidhje me praninë e një kompanie minierash në sit, si të identifikohet një grup pune për sitin dhe përfitimet dhe humbjet nga një menaxhim publik ose privat.

Në përfundim, fokus grupet ishin ideuar për të ndihmuar CHwB Albania të kuptonte çfarë duan të shohin në Spaç. Për çfarë shërben Spaçi? Rezultati i këtyre diskutimeve ishte evidentimi i rëndësisë së interpretimit dhe edukimit si forca shtytëse për sitin, që do të formësonin dhe qasjet fizike dhe administrative për t'u ndërmarrë. Mbase me më shumë rëndësi është fakti se të gjithë fokus grupet e shihnin Spaçin si një vend ku njerëzit do mësojnë për të shkuarën e vështirë të Shqipërisë e do

përballen me të – një vend ku mund të punohet me traumat dhe kompleksitet shoqërore që janë trashëgimi e asaj periudhe. Njëkohësisht, ata e shihnin Spaçin si një vend për të parë drejt të ardhmes. Ish burgu i Spaçit është një vend që mund dhe duhet të promovojë të drejtat e njeriut dhe demokracinë, duke u përballur me probleme aktuale, në mënyrë që të shërbejë si një model se si mund të jesh një qytetar i mirë në ditën e sotme. Edhe në kushtet e ashpra të Shqipërisë komuniste “ka pasur guximtarë që kanë marrë iniciativën për të dalë kundër atij regjimi, sepse të drejtat e tyre nuk respektoheshin, pavarësisht se ishin në ato kushte, ata ende besonin dhe kishin shpresë. Dhe kjo të jep forcë që ne sot, në momentin që na shkëmbin të drejtat, të mos heshtim.”¹⁹ Fuqia për të mos qëndruar në heshtje është mbase trashëgimia më e rëndësishme që Spaçi i jep shoqërisë së sotme.



¹⁹Fokus grup me studentë (fusha të ndryshme) nga Këshilli Rinor i Ambasadës Amerikane, 29 qershor 2017.

Pjesa II: Përmbledhje e diskutimeve për secilin fokus grup

Shënim: Në faqet në vazhdim, do të gjeni një përmbledhje të pikave kryesore të diskutimeve nga secili fokus grup. Citimet fjalë-për-fjalë të pjesëmarrësve janë shënuar si të tilla (" "). Sidoqoftë, organizatorët janë përpjekur të reflektojnë gjuhën origjinale të pjesëmarrësve

të fokus grupit në secilin rast, jo vetëm kur i citojnë. Për të lehtësuar leximin, pikat e diskutimit janë grupuar sipas temës në secilin grup, prandaj mund të mos jenë në rend kronologjik.

Përmbledhje e Fokus Grupit 1: Mësuesit e Lëndës së Historisë*

Kur? **6 maj 2017**

Kush? **13 pjesëmarrës (11 femra, 2 meshkuj)**

- Rëndësia pedagogjike e vizitës në Spaç:
 - o Shumë pak mësues i njohin vendet e persekutimit, burgosjes, internimit.
 - o Vizita plotëson njohuritë teorike i "koncretizon" ato dhe i mundëson mësuesve të jenë me të qartë në shpjegimet që u japin nxënësve.
 - o Fillea e një debati me veten "Ky vend nuk është pjesë e kulturës time, ndaj e kam problem që të quhet ky vend trashëgimi kulturore".
 - o Tabelat me shenjat "Kujdes" apo "Ndal" apo "Rrënojë" që tregojnë rrezik, njëkohësisht që tregojnë braktisjen e tij, mund të jenë përshtjelluese për nxënësit.
- Nevoja e përshtatjes së kurrikulave shkollore dhe nevoja që ky vend t'i shërbejë praktikave që ndiqen në fushën e mësimdhënies:
 - o Eskursione në vende të tilla duhen futur në kurrikula patjetër. Një vend i tillë i bën nxënësit të kuptojnë më mire "Një mënyrë memorializimi është futja e vizitave dhe e informacionit relevant në kurrikula. Pjesa e diktaturës është lënë totalisht jashtë".
 - o Një funksion i mundshëm mund të jetë si "laborator mësimdhënieje" me video dëshmi të mbledhura në 4 anët e vendit dhe me "reflektim aty për aty", si dhe takim me ish të burgosur politikë. Hapësirë e mundshme për workshope.
 - o Vend për evente si Konferenca Kombëtare e Mësuesve të Historisë apo Seminar me Euroclio.
 - o Publikime dhe mbështetje të përshtashme edukative për të rinjtë shqiptarë që kanë pak interes krahasimisht me të huajt.

*Për shkak të një defekti teknik te diktafonit, pasqyrimi i pikave kryesore të fokus grupit me mësuesit e lëndës së historisë është bërë kryesisht mbi bazën e shënimeve të mbajtura nga stafi ndihmës gjatë diskutimit.

- Roli i dëshmisë së gjallë gjatë vizitave:
 - o Vizita me dëshmitarë direktë është "vlerë e shtuar"(...). Ndjenja që mbizotëron është se pa udhërrëfyesin nuk kuptohet vendi.
 - o Vizita si moment i marrjes së guximit për të kuptuar: "Vij nga një familje e persekutuar... këtu e kuptoj akoma më mirë atë që kurrë nuk më kanë treguar (...) Heshtja duhet thyer (...)do të kisha dashur të kisha ardhur këtu më herët se as si studentë nuk kam qënë".
 - o Sot nuk ta jep më përshtypjen e një burgu.
 - o Integrimi i sa më shumë dëshmime të gjalla në funksionimin e vendit.
- Hapa konkretë bazuar në empirizëm dhe pragmatizëm:
 - o Ciceronë të përgatitur dhe të specializuar (profesionistë) të punojnë këtu.
 - o Krijimi i një itinerari të sigurtë dhe pajisja e vendit me rrethim.
 - o Pajisja me tualet, qasja në ujë si dhe prania e rrjetit të telefonisë mobile.
 - o Përfshirja e vendasve, si për shembull mësues e specialistë nga Rrësheni si dhe rijetizimi me asetet turistike vendase.
 - o Ndërhyrjet duhen të mbështeten tek dëshimitë, dokumentacioni ("dosjet janë"), dhe objektet që mund të kenë ruajtur vetë ish të burgosurit: "Të ngrihet mbi bazën e fakteve dhe përvojave jetike të vërteta dhe jo në bazë të thashethemeve" (...) politika nuk duhet të futet fare këtu..."
 - o Baret, restorantet dhe shërbimet e tjera vijnë vetë në një fazë të dytë.
 - o Rivendosja e telit me gjemba si element rikrijues i atmosferës së dikurshme.
 - o Vizionet e kundërta për mënyrën e trajtimit të rrugës prej 7Km: të bëhet sipas standarteve bashkohore për më shumë siguri vs të lihet si është për një përjetim sa më të afërt me atë të të burgosurve dikur...
 - o Rëndësia e përgatitjes dhe e ndërhyrjeve në rast emergjence shëndetësore apo aksidenti duke qënë se konteksti është i vështirë.
- Tema, mesazhe, teknika të mundshme:
 - o Të shfrytëzohet dhe për të folur për industrinë e bakrit, kaq të rëndësishme për zonën
 - o Dhomat e personazheve të famshme të tregojnë jetën e tyre brenda në burg.
 - o Improvizimi i një prej dhomave për të treguar "përditshmërinë" e këtij vendi.
 - o Të mos tejmbushet me informacion dhe të bëhet kujdes që mos fshihen elementë origjinalë (rasti i Vendit të Dëshmisë dhe Kujtesës në Shkodër). Duhet ruajtur mbishkrimet.
 - o Instalimi i tabelave interaktive dhe elementeve plotësues si webfaqja.
 - o Jo shumë fotografi sesa vetë objektet (krahasimisht me Bunkart 1 dhe 2).
- Aspekte të menaxhimit të Spaçit:
 - o Mekanizëm solidariteti: Një pjesë e të ardhurave që do të gjenerohet nga ky vend t'u kalohet ish të burgosurve politikë.
 - o Politika e çmimeve dhe qasja e garantuar për të gjithë audiencat: "Mos financojmë harresën duke kërkuar pagesë në hyrje të vendeve të tilla..."
 - o Të bëhet pjesë e rrjeteve ndërkombëtare të kujtesës.
 - o Rol kyç i bashkisë që mund të mobilizojë shpejt dhe mirë çdo rrjet lokal
 - o Të kërkohet mbështetje nga biznesi dhe emigracioni.

Rezultatet e pyetësorit me mësuesit e lëndës së historisë

6 maj 2017

13 pjesëmarrës

| Përpara vizitës | | Pas vizitës | |
|--|----|---|----|
| 1. Sa mirë mendoni që e njihni historinë e Spaçit? (Zgjidhni një.) | | 7. Sa ndikoi kjo vizitë për të kuptuar dhe më mirë historinë e Burgut të Spaçit? (Zgjidhni një.) | |
| Aspak | 0 | Aspak | 0 |
| Shumë pak | 0 | Shumë pak | 0 |
| Disi | 7 | Disi | 0 |
| Mirë | 3 | Goxha | 2 |
| Shumë mirë | 3 | Ndikoi shumë | 11 |
| 2. Nga e keni marrë informacionin për historinë e Spaçit? (Mund të zgjidhni më shumë se një.) | | 10. Sa e dobishmë për të kuptuar këtë vend është vizita e drejtuar nga një ish i burgosur politik? (Zgjidhni një.) | |
| Familja | 6 | Aspak | 0 |
| Shkolla | 6 | Shumë pak | 0 |
| Mediat | 6 | Disi | 0 |
| Nuk e kam marrë informacionin | 0 | Goxha | 0 |
| Tjetër* | 5 | Ndikoi shumë | 13 |
| 3. Sa mendoni që jeni i lidhur personalisht me Burgun e Spaçit? (Zgjidhni një.) | | 8. Sa ndikoi vizita në burgun e Spaçit në forcimin e lidhjes tuaj personale me këtë vend? (Zgjidhni një.) | |
| Aspak i lidhur | 4 | Aspak | 0 |
| Shumë pak i lidhur | 3 | Shumë pak | 1 |
| Disi i lidhur | 2 | Disi | 2 |
| Goxha i lidhur | 2 | Goxha | 1 |
| Shumë i lidhur | 2 | Ndikoi shumë | 9 |
| 4. Sa gjasë ka që ju të vizitoni Spaçin në kohën tuaj të lire? (Zgjidhni një.) | | 9. Sa gjasë ka që ju të vizitoni sërish burgun e Spaçit me miqtë apo familjen? (Zgjidhni një.) | |
| Asnjë gjasë | 3 | Asnjë gjasë | 0 |
| Shumë pak gjasë | 4 | Shumë pak gjasë | 0 |
| Pak gjasë | 5 | Pak gjasë | 1 |
| Shumë gjasë | 1 | Shumë gjasë | 12 |
| Nuk e di | 0 | Nuk e di | 0 |
| 5. Çfarë mendoni se mund të bëhet sot me vendet e persekutimit si Spaçi? (Zgjidhni një.) | | 6. Çfarë mendoni se mund të bëhet sot me vendet e persekutimit si Spaçi? (Zgjidhni një.) | |
| Të mos bëhet asgjë | 0 | Të mos bëhet asgjë | 0 |
| Të ruhen si dëshmi | 13 | Të ruhen si dëshmi | 12 |
| Të shkatërrohen | 0 | Të shkatërrohen | 1 |

*Tjetër: Interneti (x2); Nga individë të persekutuar pjesëmarrës në trajnimet që kam marrë pjesë; Familja ime është e prekur nga ish sistemi Komunist. Xhaxhai në vitin 1976 është burgosur në Spaç; Kam marrë pjesë [sic] në një trajnim "Fëmijet e diktaturës, ku një grup studentësh të Fakultetit të Historisë kishin bërë një film të shkurtër për burgun e Spaçit.

Përmbledhje e Fokus Grupit 2: Turistët e Huaj (Fulbright)

Kur? **21 maj 2017**

Kush? **11 pjesëmarrës (10 femra, 1 mashkull)**

- Informacion më i thelluar në Spaç:
 - o Nevojitet kontekst historik dhe një lloj analize krahasuese: kush ishin mendimtarët më të rëndësishëm? Pse është ndërtuar burgu këtu e jo diku tjetër? Çfarë ndodhte në botë dhe në pjesën tjetër të vendit në të njëjtën kohë?
 - o Do kisha dashur më shumë kontekst e më shumë statistika, më shumë histori....do t'i kishin shtuar historisë personale.
- Nevoja fizike te sitit:
 - o Tualete
 - o Shkallët, platformë e ngritur mbi çfarë është në sit (aksesibiliteti).
 - o Shkrimi dygjuhësh është shumë i mirë.
 - o Nevoja për të përcaktuar çfarë do rindërtohet, bazuar në çfarë do të kishte ndikimin më të madh – ndoshta jo ambient i gatimit, po qelitë e torturave po; këto lloj gjërash do t'i flisnin njerëzve; dhoma me 64 shtretër...
 - o Nevoja për të patur më shumë material në sit. Nëse njerëzit vinë deri këtu, duhet të kenë më shumë për të parë.
- Fuqia e historive të jetuara
 - o I duhet kërkuar të burgosurve të ndajnë historitë e tyre. Ndoshta të shkruhen në një libër kujtimesh? Ish të burgosurit janë të moshuar e do të ndërrojnë jetë së shpejti. (ashtu si Projekti Shoah ka mbledhur historitë e Holokaustit) Historite e njerëzve që kanë jetuar këtu do të ishin shumë të fuqishme.
 - o Duhet bërë një projekt i historive të jetuara. Dëshmi të regjistruara do të ishin një asset - mbani një arkivë online, në mënyrë që të jetë i aksesueshëm nga vende të tjera, nga kërkues të tjerë.
 - o "Më pëlqeu guida herën e parë. Ai kishte qënë i burgosur për 16 vite këtu dhe ndjesitë që merrje prej tij ishin shumë të mira."
 - o "Çfarë më emocionoi më shumë u tha para dy viteve (...) Krimi i tij ishte se donte të shkonte në ShBA. Arriti deri në ish Jugosllavi por ata e kthyen në Shqipëri. Kështu, u burgos për 16 vite në Spaç."
 - o "Ëndrra ishte të shkonte në Amerikë. Ëndrra ishte demokracia. Ëndrra për të është të shkojë në Amerikë e po mendoj për Amerikën tonë tani. Më trondit të qëndruarit në atë vend e të menduarit për Amerikën, që une e njoh si vendi im, duke qëndruar në këtë vend."
 - o "E jashtëzakonshme të kishim si guide këtë njeri që e ka kaluar jetën duke qënë dëshmitar, i ati i të cilit punonte në burg. Ai ishte autentik. Nuk mund të kishte ekzistuar si kamp pa këta njerëz, pa infrastrukturë. Edhe ajo është pjesë e historisë. Jeta e tij është të qënit dëshmitar i asaj ku familja e tij mori pjesë, me apo pa dëshirë, gjatë atyre viteve."
 - o Është e rëndësishme për vendin të kuptojë që komunizmi dhe periudha e komunizmit

- nuk është bardh e zi, komunistë kundër anti-komunistë. Është më e ndërlikuar se aq.
- Ide mbi interpretimin:
 - o Çdo fotografi që tregon se si ishte para se të shkatërrohej – po jo shumë foto – vetëm disa për t’i treguar njerëzve (“Është pak e vështirë për t’u vizualizuar.”).
 - o Një vizitë që reflekton mbi ritmet ditore të të burgosurve (Eastern State Penitentiary bën diçka të ngjashme)do të forconte aftësinë e njerëzve për të kuptuar ashpërsinë.
 - o Nuk do dëshiroja rikrijimin e dhomava, po disa artifakte nga ajo kohë – “disa gjëra që mund t’i japin njerëzve ndjesi që nuk transmetohen me fjalë” - që lidhen me njërit në një nivel emocional....“Çfarë vishnin të burgosurit? Me çfarë hanin? Me çfarë ushqeheshin?”
 - o Siti duhet të jetë i hapur gjithë kohën që njerëzit të vinë ta vizitojnë (jo vetëm me vizita të organizuara më parë) – edhe pse vetëm një pjesë e vogël është e interpretuar.
 - o Lidheni me shtigje tematike historike.
 - o Duhet përfshirë në kurrikulën mësimore, ndoshta nëpërmjet ekskursioneve.
 - o Vende të tjera kanë patur sukses në krijimin e vendeve ku njerëzit duan të shkojnë, po gjatë procesit kanë humbur rëndësinë e tyre si vende të kujtesës, për shkak të mënyrës në të cilën kanë punuar.
 - o Historia e flamurit dhe yllit është një paketë e thjeshtë që mund të ndihmojë në interpretimin e sitit, veçanërisht duke patur parasysht që shqiptarët e duan flamurin e tyre – përdorimi i patriotizmit mund të jetë gjë e mirë.
 - o Nëse e kufizojmë marketimin e këtij vendi vetëm te ky vend, do të tërheqë pak njerëz. Nëse kthehet në një simbol të të drejtës sociale, atëherë do të tërhiqni shumë më tepër interes. – “Pasi ta konservoni, duhet të vazhdoni ta bëni gjithmonë e më kuptimplotë.”
 - o Mund të mendojmë se jetojmë në një shoqëri post-komuniste e se kampet nuk ekzistojnë më, por ato ekzistojnë. Nëse ka një situatë bashkëkohore me të cilën mund të lidheni, atëherë bëjeni, por me kujdes.
 - A është Spaçi vendi i duhur për një muze?
 - o Një muze do ishte shumë mirë, po duhet të jetë në një qytet të madh. “Jo atje larg, sepse njerëzit nuk do shkojnë deri atje.” – të tjerë nuk janë dakord, pasi mendojnë që një muze në një qytet të madh do ishte “hapi i parë drejt një përvoje autentike” që do ishte vizita e sitit.
 - o “Njerëzit duan autenticitet.” Përvoja autentike është në vend. Duhet të shkosh deri në sit. “Vendndodhja gjeografike është pjesë e rëndësishme e historisë.”
 - o Një muze mund të vendoset në rrugën kombëtare, për t’i dhënë njerëzve një mundësi që të kuptojnë çfarë ka këtu në një mënyrë më lehtësisht të aksesueshme, duke i dhënë mundësinë të zgjedhin nëse duan të shkojnë deri atje apo jo – një tur virtual 360 gradë është gjithashtu një ide e mirë.
 - o Fillimisht duhet përcaktuar audienca e synuar dhe nëse ata do të shkonin në sit apo do t’ju dukej shumë e vështirë?
 - o Ka një mënyrë që muzeu në Tiranë dhe siti në Spaç të plotësojnë njëri-tjetrin. Spaçi duhet promovuar si një vend për t’u vizituar – “a do të kishim bërë rrugë shtesë vetëm për të shkuar në Aushwitz nëse nuk do të kishim mësuar për të në muzetë e tjerë të cilët i kemi më të lehtë t’i arrijme?”
 - o Duhet reklamuar në mënyrë intensive, duhen inkurajuar njerëzit që të ndër marrin

një udhëtim deri atje – “Nëse shqiptarët do shkojnë atje, turistët do shkojnë atje.” –është pjesë e identitetit shqiptar dhe e historisë shqiptare, prandaj duhet të jetë e rëndësishme për shqiptarët. Muzeu duhet të jetë për ta.

- Si ndihen vizitorët në sit
 - o Përdorimi i degradimit dhe izolimit sistematik – është pjesë e përvojës e të shkuarit atje dhe e përjetimit të peizazhit.
 - o “Mendoj se peizazhi ishte shumë i fuqishëm aq sa dhe pjesa mbi njerëzit ishte me më pak impakt (...) Mizoria e njerëzve ndaj njëri-tjetrit shprehej që më dërgimin e të dënuarve atje e me mbajtjen e tyre për 17, 20 vite dhe me punën në ato kushte, qartësisht shumë shumë të rrezikshme, që para se të fillonte torturimi i tyre.”
 - o “Të mendosh që ka ekzistuar për 46 vite. Kam shumë përvojë në lidhje me Holokaustin, e kam studiuar gjerësisht (...) ishte i tmerrshëm dhe kjo është e tmerrshme. Por situata rëndohet nga fakti që zgjati për 46 vite, ndërkohë që Holokausti i Hitlerit zgjati për më pak se 10 (...) M’i hapi sytë.”
- Reagime të ndryshme në lidhje me praninë e kompanisë së minierave:
 - o “E urrej.”
 - o As të tjerët nuk e pëlqenin, po e shihni me pragmatizëm – “Nuk është dicka që duam, po njerëzit duhet të ushqejnë familjet e tyre.”
 - o Drejtori i minierës po përpiqet të tregohet i kujdesshëm ndaj historisë me të cilën përballen...kanë përmiresuar rrugën...janë aty për të ndihmuar ekonominë, për të ndihmuar njerëzit, për t’i dhënë punë.
 - o Kompania duhet të japë një përqindje të fitimeve të saj për konservim.
 - o Është autentike. Ka qënë minierë në kohën që duhet të mendojmë të burgosurit duke marshuar drejt punës. Nuk duhet ta sajosh, është aty... më pak e shëmtuar tani? – lidhet me historinë e kohës; nuk ka qënë kurrë një histori perfekte ajo e minierës dhe ekonomisë në këtë komunitet.
 - o Mund t’i bëjë njerëzit të mendojnë me vetëdije mbi çështje të mëdha.



Rezultatet e pyetësorit me turistët e huaj (Fulbright)

21 maj 2017

11 pjesëmarrës

| Përpara vizitës | | Pas vizitës | |
|---|----|---|----|
| 1. Sa mirë mendoni që e njihni historinë e Spaçit? (Zgjidhni një.) | | 7. Sa ndikoi kjo vizitë për të kuptuar dhe më mirë historinë e Burgut të Spaçit? (Zgjidhni një.) | |
| Aspak | 0 | Aspak | 0 |
| Shumë pak | 3 | Shumë pak | 0 |
| Disi | 6 | Disi | 1 |
| Mirë | 2 | Goxha | 3 |
| Shumë mirë | 0 | Ndikoi shumë | 7 |
| 2. Nga e keni marrë informacionin për historinë e Spaçit? (Mund të zgjidhni më shumë se një.) | | 10. Sa e dobishmë për të kuptuar këtë vend është vizita e drejtuar nga një ish i burgosur politik? (Zgjidhni një.) | |
| Familja | 0 | Aspak | 0 |
| Shkolla | 0 | Shumë pak | 0 |
| Mediat | 0 | Disi | 0 |
| Nuk e kam marrë informacionin | 0 | Goxha | 4 |
| Tjetër* | 11 | Ndikoi shumë | 6 |
| 3. Kur ishit duke menduar për udhëtimin tuaj në Shqipëri, sa e rëndësishme ishte për të mësuar për të kaluarën komuniste të vendit gjatë vizitës suaj? (Zgjidhni një.) | | 8. Sa e dobishmë ishte kjo vizitë për t'ju dhënë një kuptim të përgjithshëm për Shqipërinë komuniste? (Zgjidhni një.) | |
| Aspak | 1 | Aspak | 0 |
| Shumë pak | 1 | Shumë pak | 1 |
| Disi | 2 | Disi | 4 |
| Goxha e rëndësishme | 2 | Goxha | 2 |
| Shumë e rëndësishme | 5 | Ndikoi shumë | 4 |
| 4. Sa gjasë ka që ju të vizitoni vendet e trashëgimisë 'së vështirë' si Spaçi kur udhëtoni jashtë? (Zgjidhni një.) | | 9. Sa gjasë ka që ju të sillni miqtë apo familjen tuaj për të vizituar vendet e trashëgimisë 'së vështirë' si Spaçi në të ardhmen? (Zgjidhni një.) | |
| Asnjë gjasë | 1 | Asnjë gjasë | 1 |
| Shumë pak gjasë | 1 | Shumë pak gjasë | 3 |
| Pak gjasë | 4 | Pak gjasë | 2 |
| Shumë gjasë | 5 | Shumë gjasë | 5 |
| Nuk e di | 0 | Nuk e di | 0 |
| 5. Çfarë mendoni se mund të bëhet sot me vendet e persekutimit si Spaçi? (Zgjidhni një.) | | 6. Çfarë mendoni se mund të bëhet sot me vendet e persekutimit si Spaçi? (Zgjidhni një.) | |
| Të mos bëhet asgjë | 0 | Të mos bëhet asgjë | 1 |
| Të ruhen si dëshmi | 11 | Të ruhen si dëshmi | 10 |
| Të shkatërrohen | 0 | Të shkatërrohen | 0 |

*Tjetër: Jonathan Eaton (x4); CHwB (x4); Vizita e mëparshme (x2); Guida 'Brandt' (x2); Libri *The Accursed Mountains*; former prisoner.

Përmbledhje e Fokus Grupit 3: Profesionistët e Muzeve

Kur? **21 qershor 2017**

Kush? **4 pjesëmarrës (1 femër, 3 meshkuj)**

- Nevojat edukative/interpretative të sitit:
 - o Lidhja mes brezave .
 - o Një impakt historik dhe emocional duhet të duket. Duhet të kapen pikat kryesore gjatë itinerarit dhe tregohen momente interesante.
 - o Mund të krijohet një grup guidash më vetë me ish-të burgosurit, për të krijuar një guidë me të rregulluar, me metodologji të përcaktuar
 - o Duhet teknika që grumbullojnë info për të dhënë info të sistemuar.
 - o “...vendosja e jo thjeshtë numrave, sepse ata njerëz që kanë qënë atje nuk kanë qënë numra. Ato njerëz kanë pas të gjithë emra.” Është e rëndësishme të vendosen të gjithë emrat e njerëzve që ishin të burgosur atje.
 - o Aktualisht nuk ekziston një itinerar, në qoftë se nuk jam me guide. Ku fillon, si shkon, ku përfundon?
 - o Është shumë mirë që tabelat janë, por janë tabela ilustruese në sens metaforik sepse kanë pak informacion. Duhet të ketë tabela informative me historinë (1-3 paragrafe).
 - o Shumë e nevojshme të bëjmë një hartë (ose një maket), me numra, etj. që identifikon pjesët e ndryshme të burgut. Në Berlin, në çdo muze të kujtesës ka një maket, që jep shumë informacion për vendin. Mund të përshkruhen edhe në mënyrë elektronike shumë detaje për përvojën e përditshme të të burgosurve. Duhet të punohet mirë dhe me historianë.
 - o Një vend për vizitorët për të lënë përshtypjet/kujtimet e tyre për Spaçin.
 - o Program edukativ.
 - o Në qoftë se kishin pjata alumini, lugë, etj, mund të vihen 500 nga këto në një vitrinë. — Mund t’i rikrijomë dhe t’i shesim si suvenire. Edhe guzhina, si menu, mund të tregohet. “Gjithëkush do donte një kujtim nga Spaçi.”
- Tematikat kryesore të lidhura me ish burgun e Spaçit:
 - o Tentativë arratisje, propagandë (arsyet që ishin futur të burgosurit politikë në burg)
 - o Jo, liria është diçka e ndryshme.
 - o Sidomos në kampin e Spaçit (dhe në të tjerë), aspekti edukativ (ri-edukimit, etj.) lidhet me shplarjen e trurit. “Kemi një rezistencë të jashtëzakonshme të ish të burgosurit pikërisht për të mos lejuar shplarjen e trurit. Dhe kjo kulmon në ‘73 në revoltë.”
 - o Ideja se të burgosurit e dinin se çfarë po ndodhte në të vërtete shumë më mirë se njerëzit jashtë burgut.
 - o Gjuhë të huaja – njerëz në burg kanë mësuar shumë gjuhë të huaja (më shumë se sa njerëzit jashtë burgut); Të burgosurit kishin mësuar anglisht, italisht, frëngjisht dhe gjuhë të tjera.
 - o Rëndësia e Revoltës së Spaçit dhe shkaqet e saj
 - o Rezistencë fizike, rezistencë ndaj torturat e tmerrshme, rezistenca në punë në kushte çnjerëzore, rezistenca ndaj injorancës — për këtë pikë, është shumë e rëndësishme

- grumbullimi i dëshmitëve (gojore dhe letërsia)
- o Aspekti intelektual (kultura) – “Të gjithë njerëzit më të ditur dhe më përfaqësues të shtresave intelektuale ishin në burg. Nuk ishin jashtë.” Pjesa më e mire e intelektualëve (të fese, dhe jo) në atë kohë ishin në burg. — “Aty është gjeneruar një kulturë.” “Spaçi e dëfton identitet tonë kombëtar.”
 - o “Ndoshta dikush ka hyrë në burg për një krim ordiner, por ka dalë i ditur prej burgut.”
 - Lidhja me peizazhin:
 - o “Në atë vend më mirë me kenë në burg.” (në lidhje me ashpërsinë e peizazhit)
 - Rëndësia e dëshmitarëve të gjallë:
 - o Vlerësoj shumë që vizita u udhëhoq nga një ish-i burgosur. E bën përvojë më të gjallë, me emocionale. Shumë e rëndësishme që krahas tabelës informuese të ketë edhe një person që jep një përvojë të plotë.
 - o Është e rëndësishme të dëgjohen dhe historitë personale të ish të burgosurve që drejtojnë vizitën, jo vetëm historinë e burgut
 - o Është e rëndësishme të bëhen intervista me njerëzit që kanë qënë aty
 - o Të identifikohen personazhet kryesore në mënyrë që të krijohet një arkivë për historitë e të burgosurve.
 - Ndërhyrjet fizike të këshilluara:
 - o Vizita në këtë fazë nuk të jep përshtypjen e burgut. Mund të jetë restaurimi faza-faza — tela me gjëmba, vëndroje, dera — ajo që jep impakt, fillimisht. Për të krijuar një far lloj kontakti me si ka qene, sidomos për brezin e ri
 - o Edhe kujdesi për shkallat, mbeturinat
 - o Detaj me shumë rëndësi është dera, si dhe pjesa e rrethimit
 - o Rindërtimi me shumë delikatesë, për të mos humbur identitetin
 - o Është shumë e rëndësishme që të kemi një tabelë në rrugë që tregon që ka një burg këtu se konsiderohet si më i famëkeq në Shqipëri
 - o 2-3 birucat e të burgosurve të pajisura, për të parë si kanë qënë. Sepse kur i shihni, jep emocion tjetër. Dyshekë me kashtë, etj.
 - o Rruga e mirë, e asfaltuar (në të njetën kohë, ka pyetje në qoftë se zbukuron vendin në qoftë se e bëjmë rrugën e mirë)
 - o Tete Albania nuk ka të drejtë të jetë atje (edhe duke marrë në konsideratë disa gjëra të mira që kanë bërë, si rregullimi i rrugës), por do të ikin në 8 vjet dhe burgu do të mbetet. “Mbas tetë vitësh, ata do ikin dhe ky, Spaçi, do mbetet. Problemi është se si do mbetet?” Duhet të shfrytëzojmë maksimalisht çfarë ofron kompania.
 - o Rrethime me karakollat që kanë qënë, të rindërtohen si kanë qënë, pa zbukurime
 - o Duhet të ketë patjetër një magazinë të vogël për relikat që janë gjetur në burg
 - o Kthimi i telit me gjëmba origjinal në Spaç nga fshatra perreth
 - o Dera kryesore, shumë e rëndësishme sepse jep idenë e burgut menjëherë
 - o Biblioteka për krimet e Enver Hoxhës dhe me të gjitha veprat e të burgosurve
 - o Të rindërtohet një kuzhinë e vogël ku ka qënë
 - o Duhet të ruhen të gjitha shkrimet mbi muret e dhomave. Ruajini këto parrulla. Mos i prishni.
 - o Një aks galerish duhet të ruhet sepse burgu nuk ishte vetëm këtu
 - o Nesër-pasnesër mund të rindërtohet dhe toga ushtarake sipër, bashkë me ato tre rrethime me tela me gjëmba

- o Duhet të dimë si funksionon dhe komanda, sigurimi i shtetit, etj.
- Diskutime praktike mbi ngritjen e një muzeu në Spaç
 - o “Ne nuk mund të marrim Spaçin dhe ta çojmë në Tiranë. Por, duhet të marrim Tiranën ta sjellim në Spaç.” — Tirana ka shumë gjera atje. “Nuk besoj që e gjithë e keqja e Shqipërisë lexohet aty.” Spaçi është tjetër. Spaçi është i nevojshëm. Nuk e bëjmë Spaçin në emër të Spaçit. E bëjmë Spaçin në emër të të tjerëve. Spaçi është më simbolik.
 - o Është e sigurtë që do të bëhet një nga vendet më të vizituara në Shqipëri pasi edhe në këtë gjendje që është tani, 4-5000 veta e vizitojnë Spaçin
 - o Nevoja për mbështetje nga qeveria — në nivelin që u bë për Shtëpinë e Gjetheve
 - » “Unë nuk jam dakord me individët që thonë që këtë punë e ka në dorë qeveria. Ne duhet të mbjellim njerëz farë të projektit.”
 - o Për të marrë financime duhet të shkruhet një draft projekt ide që të përfshijë kostot minimale për kthimin e Spaçit në muze – t’i jepet qeverisë, donatorëve – dhe më pas të bëhet një konkurs ndërkombëtar për të tërhequr vëmendjen e qeverisë
 - o Cili është target grupi? Cila do jetë strategjia? Kush do e mbështesë? – asnjë muze nuk i mbulon shpenzimet me fitimet nga biletat
 - o Në momentin që krijojmë një muze për Spaçin duhet të kemi një fushatë të mbledhim gjërat që njerëzit kanë në shtëpi.
 - o Hapat më të nevojshme: 1) Pastrimi; 2) Rrethimi; 3) Grumbullimi i materialeve; 4) Duhet të ndërtohet një program edukativ/promovues
 - o Duhet të përcaktohet që tani kush do të jetë stafi i Spaçit, në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës
 - o Duhet të hapet një portal i veçantë në emrin e Spaçit, jo në emrin e shoqatës, që jep informacion për Spaçin
 - o Bashkia mund ta menaxhojë sitin me burimet që ka
 - o Stafi që do të punojë në Spaç duhet të identifikohet që tani



Rezultatet e pyetësorit me profesionistët e muzeve

21 qershor 2017

4 pjesëmarrës

| Përpara vizitës | | Pas vizitës | |
|--|---|---|---|
| 1. Sa mirë mendoni që e njihni historinë e Spaçit? (Zgjidhni një.) | | 7. Sa ndikoi kjo vizitë për të kuptuar dhe më mirë historinë e Burgut të Spaçit? (Zgjidhni një.) | |
| Aspak | 0 | Aspak | 0 |
| Shumë pak | 0 | Shumë pak | 0 |
| Disi | 3 | Disi | 1 |
| Mirë | 1 | Goxha | 1 |
| Shumë mirë | 0 | Ndikoi shumë | 2 |
| 2. Nga e keni marrë informacionin për historinë e Spaçit? (Mund të zgjidhni më shumë se një.) | | 10. Sa e dobishmë për të kuptuar këtë vend është vizita e drejtuar nga një ish i burgosur politik? (Zgjidhni një.) | |
| Familja | 1 | Aspak | 0 |
| Shkolla | 0 | Shumë pak | 0 |
| Mediat | 1 | Disi | 1 |
| Nuk e kam marrë informacionin | 0 | Goxha | 0 |
| Tjetër* | 4 | Ndikoi shumë | 3 |
| 3. Sa mendoni që jeni i lidhur personalisht me Burgun e Spaçit? (Zgjidhni një.) | | 8. Sa ndikoi vizita në burgun e Spaçit në forcimin e lidhjes tuaj personale me këtë vend? (Zgjidhni një.) | |
| Aspak i lidhur | 0 | Aspak | 0 |
| Shumë pak i lidhur | 2 | Shumë pak | 0 |
| Disi i lidhur | 1 | Disi | 1 |
| Goxha i lidhur | 0 | Goxha | 2 |
| Shumë i lidhur | 1 | Ndikoi shumë | 1 |
| 4. Sa gjasë ka që ju të vizitoni Spaçin në kohën tuaj të lire? (Zgjidhni një.) | | 9. Sa gjasë ka që ju të vizitoni sërish burgun e Spaçit me miqtë apo familjen? (Zgjidhni një.) | |
| Asnjë gjasë | 0 | Asnjë gjasë | 0 |
| Shumë pak gjasë | 1 | Shumë pak gjasë | 0 |
| Pak gjasë | 2 | Pak gjasë | 0 |
| Shumë gjasë | 1 | Shumë gjasë | 4 |
| Nuk e di | 0 | Nuk e di | 0 |
| 5. Çfarë mendoni se mund të bëhet sot me vendet e persekutimit si Spaçi? (Zgjidhni një.) | | 6. Çfarë mendoni se mund të bëhet sot me vendet e persekutimit si Spaçi? (Zgjidhni një.) | |
| Të mos bëhet asgjë | 0 | Të mos bëhet asgjë | 0 |
| Të ruhen si dëshmi | 4 | Të ruhen si dëshmi | 4 |
| Të shkatërrohen | 0 | Të shkatërrohen | 0 |

*Tjetër: Nga miqtë e familjes që ishin të burgosur në Spaç; Profesionit; Punoja atje në vitet 1978-79; Nga miqtë si Ali Oseku, M. Velo dhe shkrimtarë të tjerë.

Përmbledhje e Fokus Grupit 4: Operatorët Turistikë

Kur? **22 qershor 2017**

Kush? **4 pjesëmarrës (4 meshkuj)**

- Elementët psikologjikë që duhet të merren parasysh në trajtimin e Spaçit:
 - o Distanca gjeografike Tiranë Spaç është me e vogël se distanca mendore Tiranë-Spaç.
 - o Nevoja për ta përjetuar në vetë të parë një vend të tillë për të kuptuar botën e persekutimit ("Kur pashë dhomën kuptova se si mund të kenë jetuar 54 vetë në aq pak vend, se kur me tha Zeneli e kisha të vështirë ta kuptoja").
 - o Nevojat janë për vende që ofrojnë mundësi ndërveprimi me vizitorët (interaktivitet) "Sot muzetë që kemi janë të mërzitshëm".
 - o Debati është ende subjektiv. "...duhet të shmangët subjektivizmi: njerëzit janë të ngarkuar emocionalisht...të gjitha palët...duhet të jetë një palë e tretë, pak më e ftohtë nga ana emocionale që gjykon më drejtë "
 - o Kush duhet të vendosë për natyrën e muzealizimit? "Nuk mund t'i lihet vendimarrja atyre që kanë qenë brenda, apo atyre të krahut tjetër, duhet të jetë një dorë tjetër, një brez i ri që s'ka gjë për të fshehur... me ftohtësinë e duhur. (...) e vërteta të vjen në të gjitha format "
- Përfshirja e dëshmitarëve ende të gjallë:
 - o Dokumentimi dëshmive të gjalla, sa janë ende dëshmitarët gjallë
 - o Dëshmitarët (ish të burgosurit politikë) t'ju shërbejnë si mentorë udhërrëfyesve të rinj që dhe këta të mund të shprehin (sadopak) emocionin që karakterizon vuajtjen dhe persekutimin. Natyrisht, emocioni i plotë/autentik mund të përcillet vetëm nga ata që kanë një lidhje direkte me Spaçin, në rradhë të parë ish të burgosurit politikë
 - o Interpretimi i vendit të mbështetet mbi dy shtylla: Forma "Faktike" (numrat, evidencat dëshmitë e dokumentuara) ndërthurur me forma "Plotësuese"(...) rrëfimi nga "dikush që e sjell të gjallë gjënë".
- Peizazhi, konteksti social, ekonomik, kulturor përreth:
 - o Me rëndësi të mendohet lidhja mes Spaçit dhe aseteve turistike përreth. Duhet t'i shërbejë më së pari komunitetit përreth. Të dyja janë kushte jetike për turizëm të qëndrueshëm
 - o Banorët vendas janë resurse kyçe, gjithashtu sepse kanë akumuluar mjaft material ndër vite
 - o Prania e minierës dhe ndryshimi i pejzazhit që ajo ka shkaktuar e vë vizitorin në siklet sepse ai është vend reflektimi dhe respektimi i vuajtjes
 - o Trendi në rritje i turistëve për këtë segment të turizmit. Kjo e bën lidhjem me operatorët turistikë shumë të nevojshme
- Hapa konkretë bazuar në empirizëm dhe pragmatizëm:
 - o Përvoja konsiston në një ndërthyrje momentesh kyçe: fillon me itinerarin që ndjek vizitori që nga pikënisja e tij (Shkodër, Tiranë, Prizren...), për t'u bashkuar në sit me banorin vendas dhe me narratorin që bën 'rrëfimin e vuajtjes (...)që nuk mund të

- tregohet ndryshe përveç se në vetën e parë’.
- o Audioguida për rastet kur grupi nuk ka guidë.
 - o Diferencimi i trajtimit në bazë të karakterit historik të elementit:
 - » Kjoska ku blihej mall dikur mund të shërbejë si pikëshitje suvenirësh, suvenirë me kuptim (jo ‘mish-mash’) si për shembull teli me gjemba.
 - » Hapësirat që dikur ishin të stafit të shërbejnë si arkiva apo për dokumentim in situ.
 - » Hapësirat e të dënuarve të shërbejnë si ekspozita.
 - o Përdorimi i dixhitales pak dhe saktë dhe jo i paneleve statikë. Përdorimi i aplikacioneve smartphone për grupmoshat më të reja.
 - o Të përdoret makineria e marketingut që është përdorur për të promovuar Bunkartet, Gjethin, brenda dhe jashtë vendit...nëpër tour operator, media, institucione. Promovim i specializuar tek opinion-bërësit si Lonely Planet, The Guardian, BBC...“ Bunkartin njerëzit e njohim përpara se të vijë”.
 - o Nevoja për rrjetizim të Spaçit si institucion me institucione të tjera të ngjashme gjatë.
 - o Të mos mbi-ngarkohet vendi me elementë të panevojshëm që nuk i përkasin. « siti ashtu si është të rrëfen gjithë atë histori...jo duke i shtuar elementë të tjerë që do e bënin të rrëmujshëm... Futja vetëm e elementëve reale (faktet) dhe promovimi i mirë janë të mjaftueshëm”.
 - o Të shmanget “segregimi” i disa personazheve të njohur nga qindra “anonimët dhe të pafatët” që kanë qënë aty që kanë vuajtur po ashtu pasojat... Kauza nuk mund të personifikohet dhe disa ndërhyrje mund ta bëjnë të duket e tillë.
- Siguria në vizitë është shqetësimi kryesor:
 - o Nevojitet sigurimi i shkallëve (meremetim dhe pajisje me korrmano)
 - o Pajisja e kateve të sipërme me elementë mbrojtës nga rënia; ose mund të mbyllen fare dhe të lihet qasje vetëm në katin e parë (përkohësisht).
 - o Sensi i vizitës tek fjetinat: të hipet nga njëri krah dhe të zbritet nga tjetri për efekt menaxhimi të flukseve të grupeve që çon në uljen e rrezikshmërisë.
 - o Pastrim i kujdesshëm i rrënojave si dhe shenjëzim orientues & parandalues (cilat janë zonat që mund të vizitohen dhe cilat jo) që vizitori të kenë gjithë informacionin e nevojshëm për sa i përket rrezikshmërisë.
 - o Vendosja e një gardhi/rrethimi që siguron perimetrin e burgut dhe të vizitës për të shmangur rastin kur njerëzit shkojnë gjatë dhe shkaktojnë potencialisht konflikt apo incidente.
 - o Të gjitha shqetësimet e shprehura amplifikohen nga vështirësia e të mbajturit në kontroll grupet turistike.
 - Ndërhyrjet mos të jenë invazive (“Disneyland”) por orientuese, mbështetëse të rrëfimit:
 - o Një dhomë të bëhet siç ka qënë dikur për të ndihmuar kuptimin. Po ashtu dhe mensa, biblioteka, qelitë e izolimit, dhe zyrat e administratës/oficerëve për të parë diferencat në kushte si dhe për të shumëfishuar këndvështrimet e mundshme.
 - o Nevoja për akses në ujë dhe tualete.
 - o Përmes arkitekturës/restaurimit njerëzit arrijnë të kuptojnë ekstremitetin e situatave në Spaç
 - o Konservimi i asaj që ka mbetur më i nevojshëm se sa restaurimi: “Nuk mund të ringjallësh një organizëm të vdekur. Mund ta konservosh, ta mbash në një gjendje të

tillë...se fundja ky është dekompozimi që i ka ndodhur memories tonë kolektive në këto 27 vite”

- Nevoja për elementin përkujtimor:
 - o Vendosja e një pllakati me emrat e të gjithë të dënuarve.
 - o Nevoja për një datë që shënon ditën e viktimave të persekutimit (mund të jetë një javë apo muaj si p.sh. Maji).
 - o Futja në kurrikulat shkollore të vizitës në Spaç
- Segmenti i 7 KM të fundit përpara Spaçit konsiderohet i rëndësishëm: trajtimi i rrugës si pjesë e konceptit tërësor interpretohet në mënyra të ndryshme:
 - o Të rindërtohet duke plotësuar të gjithë standartet e sigurisë sot;
 - o Të lihet si është por t’i shtohen elementët e sigurisë si dhe mbrojtjes ndaj shiut
 - o Rruga mund të rrijë dhe ‘spartane’ deri diku për të favorizuar një lloj turizmi të aventurës deri diku (përdorimi i makinave 4x4).

Citime të tjera interesante

- “Sot po të marrim një 18 vjeçar, e t’i themi që Zeneli ka qenë 20 vjet në burg sepse deshte me ik, kur ai (18 vjeçari) sot leviz pa viza në Evropë, thotë: Ça po thotë ky?”
- “Ne si shoqëri e evitojmë horrorin(...) ka ndodhur, është realitet...pse do ta injorosh ti?”
- “Aty është gjeneru art, letërsi, vujtje, dashni, hipokrizi, spiunllik, qelbsinllik...të gjitha duhet të tregohen aty...”



Rezultatet e pyetësorit me operatorët turistikë

22 qershor 2017

4 pjesëmarrës

| Përpara vizitës | Pas vizitës |
|--|---|
| <p>1. Sa mirë mendoni që e njihni historinë e Spaçit? (Zgjidhni një.)</p> <p>Aspak 0</p> <p>Shumë pak 3</p> <p>Disi 1</p> <p>Mirë 0</p> <p>Shumë mirë 0</p> | <p>7. Sa ndikoi kjo vizitë për të kuptuar dhe më mirë historinë e Burgut të Spaçit? (Zgjidhni një.)</p> <p>Aspak 0</p> <p>Shumë pak 0</p> <p>Disi 0</p> <p>Goxha 2</p> <p>Ndikoi shumë 2</p> |
| <p>2. Nga e keni marrë informacionin për historinë e Spaçit? (Mund të zgjidhni më shumë se një.)</p> <p>Familja 0</p> <p>Shkolla 0</p> <p>Mediat 2</p> <p>Nuk e kam marrë informacionin 0</p> <p>Tjetër* 2</p> | <p>10. Sa e dobishmë për të kuptuar këtë vend është vizita e drejtuar nga një ish i burgosur politik? (Zgjidhni një.)</p> <p>Aspak 0</p> <p>Shumë pak 0</p> <p>Disi 0</p> <p>Goxha 0</p> <p>Ndikoi shumë 4</p> |
| <p>3. Sa mendoni që jeni i lidhur personalisht me Burgun e Spaçit? (Zgjidhni një.)</p> <p>Aspak i lidhur 2</p> <p>Shumë pak i lidhur 1</p> <p>Disi i lidhur 1</p> <p>Goxha i lidhur 0</p> <p>Shumë i lidhur 0</p> | <p>8. Sa ndikoi vizita në burgun e Spaçit në forcimin e lidhjes tuaj personale me këtë vend? (Zgjidhni një.)</p> <p>Aspak 0</p> <p>Shumë pak 0</p> <p>Disi 2</p> <p>Goxha 2</p> <p>Ndikoi shumë 0</p> |
| <p>4. Sa gjasë ka që ju të vizitoni Spaçin me një grup të turistëve? (Zgjidhni një.)</p> <p>Asnjë gjasë 0</p> <p>Shumë pak gjasë 2</p> <p>Pak gjasë 0</p> <p>Shumë gjasë 2</p> <p>Nuk e di 0</p> | <p>9. Sa gjasë ka që ju të vizitoni sërish burgun e Spaçit me një grup të turistëve? (Zgjidhni një.)</p> <p>Asnjë gjasë 0</p> <p>Shumë pak gjasë 0</p> <p>Pak gjasë 0</p> <p>Shumë gjasë 3</p> <p>Nuk e di 1</p> |
| <p>5. Çfarë mendoni se mund të bëhet sot me vendet e persekutimit si Spaçi? (Zgjidhni një.)</p> <p>Të mos bëhet asgjë 0</p> <p>Të ruhen si dëshmi 4</p> <p>Të shkatërrohen 0</p> | <p>6. Çfarë mendoni se mund të bëhet sot me vendet e persekutimit si Spaçi? (Zgjidhni një.)</p> <p>Të mos bëhet asgjë 0</p> <p>Të ruhen si dëshmi 4</p> <p>Të shkatërrohen 0</p> |

*Tjetër: Njerezit; Të njohur.

Përmbledhje e Fokus Grupit 5: Këshilli Rinor të Ambasadës

Amerikane (studentë)

Kur? **29 qershor 2017**

Kush? **10 pjesëmarrës (6 femra, 4 meshkuj)**

- Nevojat në lidhje me interpretimin dhe konservimin e sitit:
 - o Për shkrimet brenda, duhet të behet diçka me këto. Duhet të dokumentohen
 - o Më shumë informacion për funksionimin e godinave
 - o Plus një fletëpalosje që mund ta marrësh me vete, dhe të lexosh dhe njëherë kur të kthehesh në shtëpi
 - o Mund të jetë dhe në formën e një aplikacioni (si Bunk'Art) – Mënyra e mirë për të tërhequr turistë të huaj
 - o Mirë që të ketë ndonjë rrëfim nga ish të burgosorit, sidomos për pjesën e qelive
 - o Të vendosim mobilje në dhoma, të krijojë ide si kanë qënë
 - o Parrullat janë shumë interesante
 - o Fotot dhe/ose emrat me të gjithë njerëzit që kanë vuajtur atje
 - o Fotot nga si ka qënë
 - o Në një dhomë, skicat me të gjitha keq-trajtimet që kishin ndodhur
 - o Një libër me rrëfimet e të gjithë të burgosurve
 - o Një shpjegim për njerëzit që kanë vdekur dhe janë të varrosur atje – një tip memorial-identifikimi
 - o Disa dhoma me situata të ndryshme, që tregojnë dicka (një tematike) për secilen dhomë
 - o Deri tani Bunk'Art 1 / 2 dhe Shtëpia e Gjethëve janë shumë të qartë, dhe simpatikë si janë bërë. Janë shumë të prekshëm. Do jetë mirë në qoftë se Spaçi mund të bëhet si ato. — Spaçi është i lidhur me to.
 - o Duhet të mësojmë më shumë mbi kategoritë e të burgosurve – duhet të kuptojmë më mirë ndryshimet e kushteve të tyre.
- Ndërhyrje fizike të nevojshme:
 - o Infrastruktura
 - o Rrugë e shtruar
 - o Shkallat
 - o Pjesa e restaurimit – por jo shumë, jo të tjetërsohet.
 - o Çfarë po ngelet, të ngelet ashtu, të ruhet.
 - o Restaurohet në lidhje me çështjen e sigurisë.
 - o Pjesa e sigurisë duhet të përmirësohet.
- Mendime lidhur me promovimin dhe qasjen në sit:
 - o Mirë të vendoset transport publik, diçka e organizuar – Një nga veshtirësitë më të mëdha është si të shkosh atje
 - o Eksursione të shkollave – “është më mirëinformues se sa një vizitë në liqen me një piknik” — Komunizmi nuk trajtohet fare në shkollë – ndalon tek reforma agrare (ose

- historia e mbretit Zog) “Kjo periudhë e historisë nuk konsiderohet.”
- o Të bëhet një dokumentar, në mënyrë që njerëzit të njihen më mirë me sitin.
 - o Përfshirë në guida, si dhe promovim; Është mirë të organizohen ture me agjensi të ndryshme.
 - o Orare të dedikuara kur është i hapur, të jetë një person atje, një zyrë.
 - o Të jetë një roje atje që angazhohet me vizitorët dhe i orienton.
 - o Mund të futet informacion për Spaçin dhe në MHK dhe në vendet e tjera me temat të lidhura – shërben si një reklamë për Spaçin, për vizitorët.
 - o “Spaçi s’është larg fare nga qendra” – mund të vizitosh edhe shtëpinë e Enverit dhe Spaçin brenda ditës
- Brezi i ri ofron një këndvështrim të ri ndaj Spaçit/ të shkuarës komuniste dhe lidhjeve me jetën e përditshme sot:
 - o “Prindërit tanë kanë shumë kompleks me atë periudhë (...) Janë shumë subjektivë se e kanë jetuar vetë. E kanë me shumë emocione. Kurse ne jemi më të ftohtë.” — Prandaj është gati në rrenim, sepse ata janë shumë me komplekse. Për të njëjtën arsye, kanë prishur piramidën, sepse thonë që lidhet me Enver Hoxhën, por s’ka lidhje. Ishte e ngritur nga populli.
 - o Çfarë mund të bëjë brezi i ri për ta larguar këtë kompleks? “Duam të njohim historinë.”
 - o Është akoma e rëndësishme të mblidhen historitë e brezit të vjetër
 - o Spaçi është pjesë e dialogut mes brezave
 - o Padënueshmërinë e njerëzve që kanë qënë – Perceptimet e njerëzve për të drejtat e njeriut... ideja që njerëzit sot janë të barabartë para ligjit (të vihet në pyetje sa nga këto të drejta i gëzojme sot në shoqërinë tonë)
 - o “Është tepër vonë, por më mirë vonë se sa kurrë.” — për të njohur të drejtat e njeriut
 - o Skllavëria moderne
 - o “Pse jemi në këtë gjendje që jemi sot?” pasoja të çfarë ka ndodhur në atë kohë. Gjendja e vështirë ekonomike, etj. ... “Ka ardhur kjo prapambetje sociale, ekonomike, nga ana e mentalitetit, kulturore” (nga e kaluara komuniste) — mbase nga historia e shkuar, “Njerëzit kanë akoma frikë të përballen me shtetin.” Kjo frikë është diçka që do mund që të kalohet nga brezi ne brez
 - o Shkelja e të drejtave të njeriut ndodhte në atë kohë, në mënyrë shumë të ashpër, por janë gjëra që ende vazhdojnë sot në mënyrë të ndryshme. Duhet t’i themi njerëzve: në qofte se të janë shkelur të drejtat, duhet ta thuash dhe t’i mbrosh të drejtat.
 - o Edhe në kushte shumë të ashpra, “ka pasur guximtarë që kanë marrë iniciativën për të dalë kundër atij regjimi sepse të drejtat e tyre nuk respektoheshin, pavarësisht se ishin në ato kushte, ata ende besonin dhe kishin shpresë. Dhe kjo të jep forcë që ne sot, në momentin që na shkelnin drejtat, mos të heshtim.” – ata njerëz janë shembull për ne sot.

Rezultatet e pyetësorit me Këshillin Rinor të Ambasadës Amerikane (studentë) 29 qershor 2017 10 pjesëmarrës

| Përpara vizitës | Pas vizitës | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
|---|--------------------|---|-----------|---|------|---|------|---|------------|---|---------|---|---------|---|--------|---|-------------------------------|---|---------|---|----------------|---|--------------------|---|---------------|---|----------------|---|----------------|---|-------------|---|-----------------|---|-----------|---|-------------|---|----------|---|--------------------|---|--------------------|----|-----------------|---|--|-------|---|-----------|---|------|---|-------|---|--------------|----|-------|---|-----------|---|------|---|-------|---|--------------|----|-------|---|-----------|---|------|---|-------|---|--------------|---|-------------|---|-----------------|---|-----------|---|-------------|---|----------|---|--------------------|---|--------------------|----|-----------------|---|
| <p>1. Sa mirë mendoni që e njihni historinë e Spaçit? (Zgjidhni një.)</p> <table style="width: 100%; border: none;"> <tr><td>Aspak</td><td style="text-align: right;">2</td></tr> <tr><td>Shumë pak</td><td style="text-align: right;">2</td></tr> <tr><td>Disi</td><td style="text-align: right;">2</td></tr> <tr><td>Mirë</td><td style="text-align: right;">4</td></tr> <tr><td>Shumë mirë</td><td style="text-align: right;">0</td></tr> </table> <p>2. Nga e keni marrë informacionin për historinë e Spaçit? (Mund të zgjidhni më shumë se një.)</p> <table style="width: 100%; border: none;"> <tr><td>Familja</td><td style="text-align: right;">3</td></tr> <tr><td>Shkolla</td><td style="text-align: right;">3</td></tr> <tr><td>Mediat</td><td style="text-align: right;">8</td></tr> <tr><td>Nuk e kam marrë informacionin</td><td style="text-align: right;">0</td></tr> <tr><td>Tjetër*</td><td style="text-align: right;">1</td></tr> </table> <p>3. Sa mendoni që jeni i lidhur personalisht me Burgun e Spaçit? (Zgjidhni një.)</p> <table style="width: 100%; border: none;"> <tr><td>Aspak i lidhur</td><td style="text-align: right;">5</td></tr> <tr><td>Shumë pak i lidhur</td><td style="text-align: right;">5</td></tr> <tr><td>Disi i lidhur</td><td style="text-align: right;">0</td></tr> <tr><td>Goxha i lidhur</td><td style="text-align: right;">0</td></tr> <tr><td>Shumë i lidhur</td><td style="text-align: right;">0</td></tr> </table> <p>4. Sa gjasë ka që ju të vizitoni Spaçin në kohën tuaj të lire? (Zgjidhni një.)</p> <table style="width: 100%; border: none;"> <tr><td>Asnjë gjasë</td><td style="text-align: right;">3</td></tr> <tr><td>Shumë pak gjasë</td><td style="text-align: right;">3</td></tr> <tr><td>Pak gjasë</td><td style="text-align: right;">2</td></tr> <tr><td>Shumë gjasë</td><td style="text-align: right;">2</td></tr> <tr><td>Nuk e di</td><td style="text-align: right;">0</td></tr> </table> <p>5. Çfarë mendoni se mund të bëhet sot me vendet e persekutimit si Spaçi? (Zgjidhni një.)</p> <table style="width: 100%; border: none;"> <tr><td>Të mos bëhet asgjë</td><td style="text-align: right;">0</td></tr> <tr><td>Të ruhen si dëshmi</td><td style="text-align: right;">10</td></tr> <tr><td>Të shkatërrohen</td><td style="text-align: right;">0</td></tr> </table> | Aspak | 2 | Shumë pak | 2 | Disi | 2 | Mirë | 4 | Shumë mirë | 0 | Familja | 3 | Shkolla | 3 | Mediat | 8 | Nuk e kam marrë informacionin | 0 | Tjetër* | 1 | Aspak i lidhur | 5 | Shumë pak i lidhur | 5 | Disi i lidhur | 0 | Goxha i lidhur | 0 | Shumë i lidhur | 0 | Asnjë gjasë | 3 | Shumë pak gjasë | 3 | Pak gjasë | 2 | Shumë gjasë | 2 | Nuk e di | 0 | Të mos bëhet asgjë | 0 | Të ruhen si dëshmi | 10 | Të shkatërrohen | 0 | <p>7. Sa ndikoi kjo vizitë për të kuptuar dhe më mirë historinë e Burgut të Spaçit? (Zgjidhni një.)</p> <table style="width: 100%; border: none;"> <tr><td>Aspak</td><td style="text-align: right;">0</td></tr> <tr><td>Shumë pak</td><td style="text-align: right;">0</td></tr> <tr><td>Disi</td><td style="text-align: right;">0</td></tr> <tr><td>Goxha</td><td style="text-align: right;">0</td></tr> <tr><td>Ndikoi shumë</td><td style="text-align: right;">10</td></tr> </table> <p>10. Sa e dobishmë për të kuptuar këtë vend është vizita e drejtuar nga një ish i burgosur politik? (Zgjidhni një.)</p> <table style="width: 100%; border: none;"> <tr><td>Aspak</td><td style="text-align: right;">0</td></tr> <tr><td>Shumë pak</td><td style="text-align: right;">0</td></tr> <tr><td>Disi</td><td style="text-align: right;">0</td></tr> <tr><td>Goxha</td><td style="text-align: right;">0</td></tr> <tr><td>Ndikoi shumë</td><td style="text-align: right;">10</td></tr> </table> <p>8. Sa ndikoi vizita në burgun e Spaçit në forcimin e lidhjes tuaj personale me këtë vend? (Zgjidhni një.)</p> <table style="width: 100%; border: none;"> <tr><td>Aspak</td><td style="text-align: right;">0</td></tr> <tr><td>Shumë pak</td><td style="text-align: right;">0</td></tr> <tr><td>Disi</td><td style="text-align: right;">0</td></tr> <tr><td>Goxha</td><td style="text-align: right;">5</td></tr> <tr><td>Ndikoi shumë</td><td style="text-align: right;">5</td></tr> </table> <p>9. Sa gjasë ka që ju të vizitoni sërish burgun e Spaçit me miqtë apo familjen? (Zgjidhni një.)</p> <table style="width: 100%; border: none;"> <tr><td>Asnjë gjasë</td><td style="text-align: right;">0</td></tr> <tr><td>Shumë pak gjasë</td><td style="text-align: right;">1</td></tr> <tr><td>Pak gjasë</td><td style="text-align: right;">3</td></tr> <tr><td>Shumë gjasë</td><td style="text-align: right;">6</td></tr> <tr><td>Nuk e di</td><td style="text-align: right;">0</td></tr> </table> <p>6. Çfarë mendoni se mund të bëhet sot me vendet e persekutimit si Spaçi? (Zgjidhni një.)</p> <table style="width: 100%; border: none;"> <tr><td>Të mos bëhet asgjë</td><td style="text-align: right;">0</td></tr> <tr><td>Të ruhen si dëshmi</td><td style="text-align: right;">10</td></tr> <tr><td>Të shkatërrohen</td><td style="text-align: right;">0</td></tr> </table> | Aspak | 0 | Shumë pak | 0 | Disi | 0 | Goxha | 0 | Ndikoi shumë | 10 | Aspak | 0 | Shumë pak | 0 | Disi | 0 | Goxha | 0 | Ndikoi shumë | 10 | Aspak | 0 | Shumë pak | 0 | Disi | 0 | Goxha | 5 | Ndikoi shumë | 5 | Asnjë gjasë | 0 | Shumë pak gjasë | 1 | Pak gjasë | 3 | Shumë gjasë | 6 | Nuk e di | 0 | Të mos bëhet asgjë | 0 | Të ruhen si dëshmi | 10 | Të shkatërrohen | 0 |
| Aspak | 2 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Shumë pak | 2 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Disi | 2 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Mirë | 4 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Shumë mirë | 0 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Familja | 3 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Shkolla | 3 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Mediat | 8 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Nuk e kam marrë informacionin | 0 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Tjetër* | 1 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Aspak i lidhur | 5 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Shumë pak i lidhur | 5 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Disi i lidhur | 0 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Goxha i lidhur | 0 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Shumë i lidhur | 0 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Asnjë gjasë | 3 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Shumë pak gjasë | 3 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Pak gjasë | 2 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Shumë gjasë | 2 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Nuk e di | 0 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Të mos bëhet asgjë | 0 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Të ruhen si dëshmi | 10 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Të shkatërrohen | 0 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Aspak | 0 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Shumë pak | 0 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Disi | 0 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Goxha | 0 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Ndikoi shumë | 10 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Aspak | 0 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Shumë pak | 0 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Disi | 0 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Goxha | 0 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Ndikoi shumë | 10 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Aspak | 0 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Shumë pak | 0 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Disi | 0 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Goxha | 5 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Ndikoi shumë | 5 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Asnjë gjasë | 0 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Shumë pak gjasë | 1 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Pak gjasë | 3 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Shumë gjasë | 6 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Nuk e di | 0 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Të mos bëhet asgjë | 0 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Të ruhen si dëshmi | 10 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Të shkatërrohen | 0 | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |

*Tjetër: Nga vizita e mëparshme.

Përmbledhje e Fokus Grupit 6: Studentët e Menaxhimit të Trashëgimisë Kulturore dhe Arkeologjisë

Kur? **30 qershor 2017**

Kush? **7 pjesëmarrës (5 femra, 2 meshkuj)**

- Rëndësia e rrëfimit nga/vizitës me ish të burgosurit politikë në Spaç:
 - o Informacioni direkt nga personi që ka qënë në Spaç është i domosdoshëm, përplotësues me informacionin ekzistues.
 - o Panelet ekzistuese ndihmuan kuptimin. Mendimi subjektiv i guidës gjithashtu, ndërthurja e tyre është efikase. Çdo tregim personal është informacion i ri.
 - o "Kur po na bënte guiden, unë u habita me qetësinë që kishte, gjendja e tij emocionale dukej shumë e ftohtë (...) ishte për t'u pasur zili ajo gjakftohtësi me të cilën ai i tregonte ngjarjet...", kjo në kundërshti me personazhe të tjerë të botës së Spaçit që kemi zakon të shohim më shpesh në media (zërat e të vegjëlve, të margjinalizuarve).
 - o Tregimi në vetën e parë dhe të qenit netruar ndihmon reflektimin "e ndien shumë impaktin e çfarë kanë kaluar këta njerëz këtu brenda". Të krijohet mundësia edhe për persona të tjerë që të rrefejnë historitë e tyre (zërat e shumëfishtë).
 - o "Spontaniteti", "tregonte atë që i vinte në mendje" (...) të bën të afroresh pak më shumë me historinë e tij, të ndihesh më i miqësuar me të".
- Ndjesite, atmosfera:
 - o Sot në vendet e tjera muzeale të kohës së komunizmit, fryma "trendi" mbizotëron, ku shkon dhe bën foto me gjëra të vjetra. "Spaçi duhet të jetë krejtësisht rasti i kundërt i të shkuarit atje që të kenaqesh me foto, por duhet të të japë atë ndjesinë...të dalësh paksa i tronditur(...) Ai që vjen këtu vjen për të përjetuar dramë (...).
 - o Jo e gjithë atmosfera të jetë zyrtësia por të kombinojë regjistra të ndryshëm emocionalë "që jo e gjithë eksperiencia të jetë në formë traume"
- Ndërrhyrjet pragmatiste:
 - o Siguria është e para, konsolidimi i ndërtesave, rikrijimi i disa ambienteve për të dhënë idenë e çfarë ka qënë..."ta kthejmë si ishe...nuk shoh ndonjë benefit..."
 - o Rikrijimi i disa prej ambienteve – si dhe i situatave ku vizitori i nënshtrohet një prej këtyre proceseve "çhumanizuese", si për shembullurvejimi. "E parë kështu siç është tani duket si ato fabrikat e vjetra të kohës së komunizmit (...)"
 - o Rikrijimi i hyrjeve dhe telave me gjemba...për të rikrijuar përjetimin e atëhershëm. "Të pakten ata që kanë lindur pas viteve 90 – dhe që nuk i kanë parë në filmat shqiptarë të tillë vende, por me çfarë kanë parë nga filmat nga jashtë, - të krijojnë idenë se si ka qënë ky vend".
 - o Rikrijimi i oborrit ku dilnin të burgosurit sepse "ai njëorëshi i ajrosjes ishte sinonimi i lirisë për ta".
 - o Shtimi i disa shenjave orientuese për të kuptuar ku fillon e mbaron burgu, drejtimi i qartë i vizitës, etj.
 - o Dhomat, fjetja me 50 veta të tjerë në dhomë, ku të nxirret në pah se si kanë qënë

- kushtet krahasimisht me kushtet sot.
- o Komforti, si për shëmbull tualeti.
 - o Shtrimi i rrugës për lehtësi vizitimi/akses. Në gjenjen aktuale mund të shkohet dhe me veturë të vogël. Mundet dhe që të ketë mundësi vizitori, ta ketë pak ndjesinë e të shkuarit atje si kanë shkuar të burgosurit dikur...Për këtë qëllim mund te lihet një segment i vogël i paprekur afër hyrjes...
 - Elementët 'transversale' që duhet të jenë pjesë e narrativës:
 - o Ashpërsia e vendit ku ndodhet Spaçi.
 - o Elementi iurvejimit i kudondodhur (qoftë në tipare e objekteve, qoftë tek vetë njerëzit)
 - o Të synohet krijimi i një ndjesie individuale te vizitori që bëhet ose duke e servirur të gatshëm subjektin ose duke e ndihmuar atë ta kuptojë përmes subtiliteteve dhe zgjidhjeve të mençura
 - o Të tregojë se si kanë jetuar ata persona. Çfarë kane veshur? Me çfarë janë ushqyer, etj.
 - o Orenditë, objektet, sendet me të cilat mund të pajiset ish-burgu:
 - » Mbledhja e tyre nga ish të burgosur që gjenden sot në të gjithë Shqipërinë.
 - » Orenditë që kanë qënë dikur në burg jo thjesht si një dekor "(...) nuk dua që të komercializohet që të shkojnë njerëzi e të bëjnë foto, sellfi...se kjo gjë është mungesë respekti totalisht."
 - o Nivele të ndryshme informacioni për ata që duan të thellohen apo ata që konsumojnë informacion vetëm aty për aty.
 - Ndërveprimi:
 - o Muzeu është funksioni me i mire. Nëse është muze është dhe edukues. Të niset me vizita nga gjimnazet, jo menjëherë nga fëmijët për të cilët mund të jenë histori pak të rënda...
 - o Vendosja e një tablele ku vizitori shpreh atë që ndjen pas vizitës
 - o Të nxirret në pah arti që këta të burgosur kanë bërë gjatë kohës së qëndrimit në burg (si për shembull të degjosh këngët që ata kanë bërë...jo domosdoshmërisht të jetë origjinale por që të tregojë se çfarë ka ndodhur)
 - o Trupe aktorësh që aktrojnë në momente të caktuar për të risjellë ndjesinë apo për të interpretuar momente të caktuara nga jeta reale aty brenda
 - o Vendi ideal për koncerte të rrymave alternative (punk, rock) sepse ndjenja e revolucionit tek rinia shqiptare është e vakët
 - o Evente për lirinë e fjalës, demokracinë, si për "ironi" të asaj që përfaqësonte dikur ky burg
 - Përfshirja dhe eksperimentimi:
 - o Të mendohet që tani dhe për personat me aftësi ndryshe (si për shembull panelet të jenë gjithashtu në alfabetin breil).
 - o Mund të tentohet një qasje me historitë e figurave të njohura në fillim për të arritur atë impaktin e menjëhershëm tek publiku.
 - o Instalacionet artistike për shembull mbi rrethimin dhe mënyrat arratisjes. Një ide instalacioni me rrobat mbi gjemba...
 - o Pasurimi i përvojës duke luajtur me shqisat: efektet dritat, zhurmat (si për shembull instalimi i një sirene).

- o Objektet që do jenë aty të kenë një shpjegim, narrativë më mirë të përcaktuar...
- o Të kihet kujdes në anën komerciale, sepse ky nuk është një vend ku thjesht shiten bileta.... Menaxhimi publik apo privat i tij ha gjithashtu shumë debat. Të menaxhohet nga bashkia Mirditë që t'i shërbejë si levë e forte për turizmin, pra rritjen e të ardhurave.
- o Të minimizohet ndëhryja e politikës ose të shmanget fare, mos të përdoret për interesa të momentit
- o Kombinimi i Muzeut dhe elementi i natyrës rrethuese (lidhje me kontekstin) "muze vetëm aty brenda por dhe përreth"
- o Krijimi i një fondi solidariteti nga fitimet e mundshme të Spaçit që i shkon edukimit të rinjve mbi këto çështje.
- Tematikat:
 - o Tematika bashkëkohore e minierave/ minatorëve që vazhdojnë të punojnë në kushte skandaloze të punës.
 - o Të flasë jo vetëm për Spaçin, por dhe për burgje të tjera të kohës.
 - o Të flasë dhe për rojet si ata që ishin 'në mes'. Të tregohet historia e tyre. Historia e gjithkujt dhe jo vetëm e të burgosurve. Kush ishte realisht i lirë dhe kush i burgosur? "Edhe këta që punonin gjithmonë për sistemin, të lirë nuk ishin (...)"
 - o Çështjet e seksualitetit dhe identitetit gjinor gjatë dhe pas komunizmit.
 - o Pushteti dhe personi : përdorimi i pushtetit nga kush e ka në dorë.
 - o Të lihet vend në koncept edhe për periudhën e degradimit nga vitet 90 e tani "(...) rrefuzimi total që i ben një shoqëri një të keqeje...në vend që të përballet me të, zgjedh rrugën më të lehtë; që është harresa (...)"



Rezultatet e pyetësorit me studentët e menaxhimit të trashëgimisë kulturore dhe arkeologjisë 30 qershor 2017 7 pjesëmarrës

| Përpara vizitës | Pas vizitës |
|--|---|
| <p>1. Sa mirë mendoni që e njihni historinë e Spaçit? (Zgjidhni një.)</p> <p>Aspak 1</p> <p>Shumë pak 2</p> <p>Disi 4</p> <p>Mirë 0</p> <p>Shumë mirë 0</p> | <p>7. Sa ndikoi kjo vizitë për të kuptuar dhe më mirë historinë e Burgut të Spaçit? (Zgjidhni një.)</p> <p>Aspak 0</p> <p>Shumë pak 0</p> <p>Disi 0</p> <p>Goxha 4</p> <p>Ndikoi shumë 3</p> |
| <p>2. Nga e keni marrë informacionin për historinë e Spaçit? (Mund të zgjidhni më shumë se një.)</p> <p>Familja 3</p> <p>Shkolla 0</p> <p>Mediat 4</p> <p>Nuk e kam marrë informacionin 1</p> <p>Tjetër* 0</p> | <p>10. Sa e dobishmë për të kuptuar këtë vend është vizita e drejtuar nga një ish i burgosur politik? (Zgjidhni një.)</p> <p>Aspak 0</p> <p>Shumë pak 0</p> <p>Disi 0</p> <p>Goxha 0</p> <p>Ndikoi shumë 7</p> |
| <p>3. Sa mendoni që jeni i lidhur personalisht me Burgun e Spaçit? (Zgjidhni një.)</p> <p>Aspak i lidhur 4</p> <p>Shumë pak i lidhur 1</p> <p>Disi i lidhur 2</p> <p>Goxha i lidhur 0</p> <p>Shumë i lidhur 0</p> | <p>8. Sa ndikoi vizita në burgun e Spaçit në forcimin e lidhjes tuaj personale me këtë vend? (Zgjidhni një.)</p> <p>Aspak 0</p> <p>Shumë pak 1</p> <p>Disi 2</p> <p>Goxha 3</p> <p>Ndikoi shumë 1</p> |
| <p>4. Sa gjasë ka që ju të vizitoni Spaçin në kohën tuaj të lire? (Zgjidhni një.)</p> <p>Asnjë gjasë 2</p> <p>Shumë pak gjasë 1</p> <p>Pak gjasë 1</p> <p>Shumë gjasë 2</p> <p>Nuk e di 1</p> | <p>9. Sa gjasë ka që ju të vizitoni sërish burgun e Spaçit me miqtë apo familjen? (Zgjidhni një.)</p> <p>Asnjë gjasë 0</p> <p>Shumë pak gjasë 0</p> <p>Pak gjasë 0</p> <p>Shumë gjasë 5</p> <p>Nuk e di 2</p> |
| <p>5. Çfarë mendoni se mund të bëhet sot me vendet e persekutimit si Spaçi? (Zgjidhni një.)</p> <p>Të mos bëhet asgjë 0</p> <p>Të ruhen si dëshmi 7</p> <p>Të shkatërrohen 0</p> | <p>6. Çfarë mendoni se mund të bëhet sot me vendet e persekutimit si Spaçi? (Zgjidhni një.)</p> <p>Të mos bëhet asgjë 0</p> <p>Të ruhen si dëshmi 7</p> <p>Të shkatërrohen 0</p> |